

NEBI BARDHOSHI

ARSIM CANOLLI

KOSOVA ANTROPOLOGJIKE¹

Hyrje

Në tri dekadat e fundit Kosova ka qenë objekt i studimeve të shumta në konverzacionin akademik ndërkombëtar në shkencat shoqërore, pasi vetë realiteti i Kosovës ka pësuar ndryshime të mëdha me implikime të mëdha dhe, si i tillë, ka qenë edhe përndjellës për interesin e studiuesve. Megjithatë, në vërtetim të parë, në këtë konverzacion vërehet se dominojnë studimet politologjike, shpeshherë me kontribute të ndërthurura nga disiplinat e tjera. Nga ky vërtetim duket se interesimi kryesor në komunitetin akademik ka qenë ai politik; pas rënies së Jugosllavisë, fokusi kryesor ra mbi ndërhyrjen e NATO-s më 1999 dhe fazën e shtetndërtimit të Kosovës, para dhe pas pavarësisë së saj më 2008. Duket se pyetja se çfarë lloj shteti po bëhet Kosova, si objekt *sui generis* i ndërhyrjes ndërkombëtare, ka përndjellë studime të shumta.² Por, nuk mohohet se gjatë këtyre dekadave, sidomos në

¹ Ky kontribut është pjesë e vëllimit *Kosova antropologjike*, përgatitur nga Nebi Bardhoshi dhe Arsim Canolli. Tiranë: Akademia e Studimeve Albanologjike, 2020. Titulli “Kosova antropologjike” është vendosur me synimin që të jehojë me titullin e shkrimit të Rrok Zojzit “Kosova pitoreske” që nuk arriti të bëjë etnografinë e tij në Kosovë pas vendosjes së diktaturës më 1945 dhe mbylljes së kufirit mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë në vitin 1948, e na la vetëm disa dromca të botuara gjatë Luftës së Dytë Botërore. Në kontekst të standardit të ligjërimit të zakonshëm ky titull, apo emërtim, edhe mund të mos qëndrojë nga ana semantike.

² Shih, për shembull: Weller 2009; Ante 2010; Zaum 2007; Visoka 2017; Landau 2017, 442-463; Musliu 2019, 556-565; Beha 2019, 674-689; Strohle 2012, 223-250. Ekziston një mori studimesh mbi temat e shtetndërtimit, paqendërtimit, pas ndërhyrjes etj., që vijnë nga politologjia dhe marrëdhëniet ndërkombëtare, të cilat nuk i kemi cituar këtu.

vitet '90-të, ka pasur një interesim mjaft specifik mbi historinë e përgjithshme të Kosovës (Malcolm 1998), e cila në vitin 1989 bie nën regjimin e dhunshëm të Serbisë dhe gjatë viteve '90 organizon rezistencë civile paqësore. (Howard 2000) Nga ana tjetër, kryesisht pas luftës së viteve 1998-1999, Kosova fillon të marrë vëmendjen edhe nga shkencat e tjera shoqërore, ku filluan studimet mbi të kaluarën socialiste, identitetin e aspekte të tjera të jetës sociale në shoqërinë kosovare.³

Nga pamja që del nga këto studime vërehet se Kosova ka kaluar nëpër pragje të shumta ndryshimi, sidomos gjatë shekullit XX. Pa dyshim se këto ndryshime kanë lënë efekt në botëkuptime, sjellje, institucione, interpretime e në të gjitha avenytë e jetës shoqërore. Në tri dekadat e fundit, në vllugun e përvojës së përpjekjes për të ndërtuar shtet, ndryshimet e transformimet shoqërore kanë qenë edhe më të mëdha në përvojën e shoqërisë kosovare. Shoqëria kosovare kalon një dramë politike dhe sociale (Turner 1969) mjaft specifike, duke dalë nga një shoqëri e një miqësie të detyrueshme gjatë Jugosllavisë së unitetit të planifikuar komunist të etnive të ndryshme, të njohur si “bashkim-vëllazërim”, te një shoqëri shtetformuese në kontekst të pluralizimit demokratik, të pranuar, të njohur, të kontestuar, në dialog e negociata të përherëshme për t'u bërë.⁴ Në këtë kontekst, studimet antropologjike/etnologjike do të duhej të ishin perspektiva studimore më e frytshme për ndryshimet shoqërore, botëkuptimet, raportet dhe zhvillimet e ndryshme në sferën shoqërore e kulturore të një shteti të ri që, dashje pa dashje, ripërkufizon edhe sjelljet shoqërore e botëkuptimet kulturore. Megjithatë, ndonëse kërkimet antropologjike/etnologjike kanë peshë të rëndësishme në vrojtimin e interpretimin e ndryshimeve të jetës e sjelljes njerëzore përballë, prapa dhe në raport me ndryshimet e tilla, që zakonisht bëhen në kontekst të asaj që njihet edhe si “antropologji e postkomunizmit apo postsocializmit” (Hann 2002, 28), interesimi antropologjik mbi Kosovën, dhe kësaj drame politike gjatë tri dekadave të fundit, mbetet i kufizuar; të paktën më i kufizuar se në disiplinat e tjera.

³ Krasniqi 2012, 353-366; Krasniqi 2011a, 336-354; Krasniqi 2011b, 191-207; Krasniqi 2014, 104-106; Krasniqi dhe Simkus 2015, 295-321.

⁴ Për një pamje të thukët shih: Malcolm 1998, kurse një pamje historike, përqendruar edhe tek aspektet sociale jepet tek: Schmitt 2012.

Kemi raste edhe kur antropologut gjatë punës në terren i thuhet “pse po merresh me bukën, kur sot ka rëndësi veç politika” (Canolli 2014, 17), dhe kjo duket se shpreh impulsin kërkimor të kohës mbi Kosovën, që, si shoqëri, tërheq vëmendjen e vrojtimit politologjik më shumë se sa atij antropologjik.

Pa dyshim, në dekadën e fundit, studimet antropologjike mbi Kosovën janë shtuar si nga studiuesit e huaj, ashtu edhe nga studiuesit shqiptarë, si në gjuhët e huaja, ashtu edhe në gjuhën shqipe. Një antropologji e Kosovës, e rikonceptualizuar në aspektin teorik, metodik dhe qasës, është tashmë e dukshme në peizazhin studimor të Kosovës dhe sa vjen e rritet. Një hap i mirë në atë drejtim është edhe kjo përmbledhje.

Baza të shkrimeve që po paraqesim këtu janë kumtesa të paraqitura në simpoziumin "Perspektiva studimore mbi Kosovën", mbajtur në Tiranë, në datat 20-21 dhjetor 2019. Ky simpozium u organizua nga Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe i Studimit të Artit, në bashkëpunim me Departamentin e Antropologjisë, Fakulteti Filozofik, Universiteti i Prishtinës. Simpoziumi ishte një përmbyllje në kuadër të vitit kushtuar studimeve etnologjike dhe antropologjike mbi Kosovën. Një aktivitet i tillë u bë në kuadër të përvjetorit të 20-të të çlirimit të Kosovës. Simpoziumi u mbajt si një aktivitet përmbyllës, pasi i gjithë viti 2019, në Institutin e Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit, iu kushtua njohjes me studime e projekte kërkimore të antropologjisë dhe dijeve të tjera mbi shoqërinë kosovare. Në themel të kësaj ideje ishte njohja me studime empirike dhe kritike me autorë vendas, pra nga Kosova. Prezantimet e këtyre punimeve u bënë në kuadër të seminarit permanent “Përthyerje antropologjike” si dhe në platformën "Tragë". Si në "Përthyerje antropologjike", ashtu dhe në "Tragë", i ftuari kishte mundësinë të mbante një leksion të detajuar mbi metodën, analizën dhe rezultatet e arritura (Pasqyra shkencore 2019, 1-12). Edhe simpoziumi u organizua duke ndjekur këtë model. Studiuesi ftohej të mbante një fjalë, e cila përmbante një reflektim të autorit mbi punën kërkimore që kishte realizuar ndër vite dhe, ndërkohë, të veçonte rishikime dhe shqyrtime të reja mbi tezën apo tezat e botuara ose jo.

Koha e mbajtjes së këtij aktiviteti ishte fill pas tërmetit të 26 nëntorit të vitit 2019, që la pas shumë të vdekur në Shqipëri. Prandaj na u desh ta

shtynim si aktivitet për disa ditë, por në fund çdo gjë shkoi si duhet. Në fakt, intensiteti i debatit të këtij simpoziumi do të mbahet mend gjatë. Simpoziumi ka pasur më shumë të ftuar se sa do të paraqiten në këtë përmbledhje. Gjejmë rastin t'i falënderojmë të gjithë pjesëmarrësit për fjalët e paraqitura dhe pjesëmarrjen aktive në të gjithë debatin e ndjekur. Në brendi të saj gjenden perspektiva studimore që secili studiues ka aplikuar apo është duke aplikuar ende në kërkimet e veta mbi Kosovën. Prandaj, shpresojmë që në të ardhmen ky vëllim do të pasohet nga botime të tjera, të cilat do të inkuadrojnë edhe më shumë perspektiva nga brenda dhe jashtë Kosovës e, kështu, të dalin sa më shumë vështirime antropologjike. Në vijim po paraqesim një pamje të shkurtër të mendimit etnologjik/antropologjik mbi Kosovën. Ndërsa në fund, në mënyrë të përmbledhur, do të paraqitet shkurtimisht përmbajtja e secilit kontribut.

Fillet etnografike

Në fillet e veta, kureshtja e udhëtarit evropian, që nisete cepave të kontinentit të vet apo drejt shtigjeve të reja përtej vendit të tij, duket se ka qenë e përafërt me kureshtjen e etnografit të trajnuar. Këtë e shohim edhe te historia e udhëpërshkrimeve edhe tek ajo e mendimit etnologjik. Si udhëpërshkrimi, ashtu edhe etnografia janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, sepse të dyja këto gjini janë në thelb të lidhura me kureshtinë e udhëtarit, dëshirën, drojën, habinë që të ngjall një tokë dhe njerëz të patakuar më parë, habinë e kureshtinë që ngjall shumësia dhe varietetet kulturore. Ndoshta etnografët e trajnuar, apo antropologët e trajnuar, në fund të shekullit XIX dhe fillim shekullit XX, kanë qenë të orientuar të mendojnë si evolucionistë, për shkak të faktit se ka mbizotëruar historicizmi, teoria evolucioniste e më vonë difuzioniste, por edhe ata udhëtarë që kanë lënë udhëpërshkrime janë të prirur që në përshkrimet e tyre të lënë evidenca për “atë që duket se ka mbijetuar nga lashtësia”.

Kureshtja etnografike për Kosovën nis qysh herët. Ajo nis krahas kureshtjes evropiane për gjithë rajonin, e shqiptarët në veçanti. Rreth mesit të shekullit XIX, deri në mbarimin e Luftës së Dytë Botërore, një mori udhëtarësh, priftërinjsh, diplomatësh e kureshtarësh të ndryshëm kaluan apo jetuan për ca kohë aty dhe mbajtën shënime me natyrë etnografike për

Kosovën. Situata politike në Europë dhe në Perandorinë Osmane, pjesë e së cilës ishte Kosova, po përballej nga një mori ndryshimesh politike, ku si truall ndryshimesh kishin kryesisht Perëndimin, i cili do të imponohej edhe në kohë krizash me modelet e mendimit dhe sistemeve politike. Kjo situatë kishte përfshirë në fakt edhe gjithë botën, ku rryma të ndryshme ideore, politike, ideologjike ishin kahmos të pranishme. Për shkak të dinamikës historike, mendimi etnologjik mbi shqiptarët dhe Ballkanin dominohet nga mendimi gjermanik për shumë kohë. Tradita etnografike gjermanike ka depërtuar në mënyra të ndryshme tek etnologjia kosovare. Një shteg është nëpërmjet shkollës etnologjike, ku janë formuar studiuesit dhe, së dyti, është trangu albanologjik, i cili në thelb i përket shtratis etnologjik gjermanik (Promitzer 2015, 189-206; si dhe Heming 2012, 115-130). Nuk duhet harruar se si imagjinata herderiane [volkgesit], e Ratzelit [antropogjeografia], ashtu dhe ajo marksiste-engelsiane [materializmi dialektik], i ka bazat te bota e mendimit gjermanik. Vetë bota e dijes antropologjike gjermanike njeh shumë qasje, autorë e shkolla të ndryshme, por, sidoqoftë, vetë etnografia si metodë dhe si shkencë duket se i ka pasur themelet e saj më të hershme pikërisht në këtë territor, ku, në njërën anë, u hodhën themelet e një shkolle mbi tjetrin e, në anën tjetër, mbi veten.⁵ Nuk ka dyshim që secila shkollë kombëtare etnologjike në Ballkan, Evropë Qendrore, Lindore dhe më gjerë ka realizuar përthyerjet e veta, por, në tërësi, studimi etnologjik mbi popujt e Ballkanit, nga mesi i shekullit XIX e deri në fillim të shekullit XX, dominohet nga pikëpamje që shtrojnë pyetjet rreth origjinës etnike, shtrirjes së kulturës, përhapjes së saj në treva të caktuara e, në fund të fundit, të etnologjisë si një shkencë mbi etninë, e lidhur ngushtë me krijimin e përfytyrimit të territorit historik, bashkëkohor dhe imagjinar mbi kombin dhe, për rrjedhojë, për shtetin.

Fillimisht shqiptarët si popull përndjellin imagjinatën e udhëtarëve, shkrimtarëve dhe ushtarakëve perëndimorë, dominuar nga vështrimi i përshkruesit anglez. Rugës drejt gjermadhave antike në Greqinë e “të gjithë zotave” (1828) si vend i imagjinatës evropiane, rugës për të takuar Ali Pashë Tepelenën si faktor politik në një nyje politike të Mesdheut, këta

⁵ Vermeulen 2015. Për një vështrim kritik të mënyrës se si është keqkuptuar "imperializmi gjerman" në Perandorinë Osmane shih: Marschand 1996, 298-336.

udhëtarë, diplomatë e kureshtarë, dëgjuan gjuhë e vrojtuan doke të një populli që s'i kishin dëgjuar e parë më herët. Studiuesi i parë që na la shënime mbi Kosovën, ishte Ami Boué, në veprën e tij shumë të njohur, konsideruar monumentale për nga mënyra e trajtimit dhe influenza që pati më vonë në imagjinatën etnografike mbi Ballkanin.⁶ Po ashtu, Georg von Hahn, që më vonë njihet si babai i albanologjisë dhe “zbuluesi i kombit shqiptar” për bashkësinë e studiuesve, do të kalonte disa herë nëpër Kosovë dhe do të jepte të dhëna etnografike dhe vlerësime për Kosovën, tiparet e sjelljet e shqiptarëve, sistemin fisnor etj.⁷ Pa dyshim se ka edhe studime të tjera në kuadër të studimeve arkeologjike,⁸ e udhëpërshkrime të tjera që dalin në shesh gjatë leximit të bibliotekës albanologjike të kësaj periudhe, të cilët shprehin edhe vrojtimit nga Kosova.⁹ Ndër udhëtarët e studiuesit e

⁶ Boué, Ami. 1854. *Recueil d'itinéraires dans la Turquie d'Europe. détails géographiques, topographiques et statistiques sur cet empire*. Vienna: W. Braumüller. Pjesët që ia dedikoi vështrimeve etnografike mbi Kosovën janë f. 192-208, 346-352 dhe 315-318.

⁷ Hahn, v. Georg. 2007. *Studime shqiptare*, Tiranë: IDK; Hahn, v. Georg. 2006. *Udhëtim nëpër viset e Drinit dhe Vardarit*. Prishtinë: Rozafa. *Studime shqiptare* i von Hahnit është botuar në gjuhën gjermane më 1851. Në vitin 2015, studimet e tij përkthehen në gjuhën angleze. Hahn, v. Georg. 2015. *The Discovery of Albania: Travel Writing and Anthropology in the Nineteenth Century Balkans*. Përkthyer nga Robert Elsie. London: IB Tauris & Centre for Albanian Studies.

⁸ Shih: Evans, Arthur. 1883. *Antiquarian researches in Illyricum. (Parts I and II). From The Archaeologia Vol. XLVIII*. Westminster: Nichols and Sons; Evans, Arthur. 1885. *Antiquarian researches in Illyricum, Parts III, IV*, *Archaeologia: or, Miscellaneous Tracts Relating to Antiquity*, Volume XLIX. London: Nichols and Sons, for the Society of Antiquaries of London. Së fundi, janë botuar vëllimet: Evans, J. Arthur. 2006. *Ancient Illyria: An Archaeological exploration*, London: London: IB Tauris & Centre for Albanian Studies. Evans shkruan edhe raporte e letra, të cilat kanë vrojtme mbi Lidhjen e Prizrenit e personazhe historike të kohës. Për një përmbledhje shih: Evans, J. Arthur. 2017. *Albanian Letters: Nationalism, Independence and the Albanian League*, përgatitur nga Bejtullah Destani dhe Jason Tomes. London: IB Tauris & Centre for Albanian Studies.

⁹ Konsiderojmë se ekzistojnë, përafërsisht, diku mbi 300 botime në gjuhë të ndryshme nga udhëpërshkruesit mbi Shqipërinë, prej fillimshekullit XIX e deri në Luftën e Dytë Botërore, ku, ndoshta, mbi gjysma janë shkrime mbi Kosovën, por ka edhe shkrime të tjera mbi Serbinë e Ballkanin, që shpesh rrokin edhe Kosovën.

kohës spikatet intuita antropologjike e Edith Durham-it, e cila ka lënë një prozë mjaft elegante në fillim të shekullit XX. Në veprën *Shqipëria e epërme*, (Durham 1909) shfaqet edhe Kosova, vendi që ajo e pagëzoi si “i debatueshëm”, e ku plot 90-91 vite më vonë do të përfshinte në debatin rreth saj dijetarë, politikanë, analistë, artistë, ushtarakë, thuajse në rang botëror. Përshkrimet dhe tezat e Durham-it njihen mirë nga lexuesi, pasi pjesa kryesore e punëve të saj janë botuar e ribotuar në gjuhën shqipe. Për imagjinatën antropologjike ato marrin rëndësi, pasi ato botohen në një nga revistat antropologjike më të njohura të kohës siç është revista *Man*, dhe për faktin se botimet e saj në anglisht do të bëheshin shumë më të aksesueshme për dijen antropologjike në rang botëror.¹⁰ Botimi në anglisht bëhet i rëndësishëm për dijen antropologjike, për zhvillimet që mori antropologjia në botën anglosaksone dhe disfatës që pësoi mendimi antropologjik gjermanik për shkak të nazizmit, dhe, në fakt, edhe para tij. Gjuha angleze u bë dominuese në kohën kur shqiptarët po rizbuloheshin nga antropologjia. Rizbulimi nga antropologjia botërore fillon në Kosovë në vitet 1970 e në vijim, si dhe pas rënies së komunizmit në Shqipëri.

Në katër dekadat e para të shekullit XX Kosova kaloi drama politike e sociale të jashtëzakonshme, ku mbretëroi dhuna, dëbimi e kolonizimi. Kjo ishte koha e programeve etno-nacionaliste të Serbisë, për të “ri-kthyer” Kosovën apo “Serbinë e vjetër”, siç quhej Kosova në to. Gjatë kësaj periudhe, mendimi nationalist serbomadhi, me premisa etnologjike, i nisur nga akademikët e Beogradit, kryesisht nga shkolla e Ivan Cvijiqit,¹¹ filloi të

Për një pamje të shkurtër të 100 prej tyre shih: Abdullahu 2018. Fondi i Bibliotekës Kombëtare të Kosovës “Pjetër Bogdani” është mjaft i pasur me këto botime në gjuhë të ndryshme.

¹⁰ Durham ndërmori udhëtimin e parë në vitin 1908. Kohë e Kushtetutës në Perandorinë Osmane, kohë bese për trojet që ajo përshkroi. Botimi origjinal: Durham M. Edith. 1909. *High Albania*, London: Edward Arnold Publishers to India Office.

¹¹ Imagjinata mbi tjetrin si inferior në gërshtetim më shumë prej ideve raciste e eugenike, që qarkullonin në botën perëndimore, erdhi edhe shfrenimi më banal në mendimin serb mbi shqiptarët, që ishin shumica e madhe në Kosovë, duke i quajtur edhe njerëz me bisht, siç është rasti i Vladan Gjorgjeviçit. Shih: Gjorgjeviç 2015 [1913].

marrë hov të madh. Ky mendim u përkthye edhe në propagandë ndërkombëtare kundër shqiptarëve, strategji për shtetin serb dhe diskurs etno-nacionalist për shkollën serbe. Megjithatë, udhëtarët, diplomatët, misionarët e vendeve të ndryshme perëndimore bënë përshkrimet e tyre, të cilat u botuan në dekadat e para të shekullit XX.¹² Nuk duhet harruar se, gjatë Luftës së Parë Botërore, antropologjia gjermanike u përfaqësua në rajonin e Ballkanit më së tepërmi nga bota austriake. Pjesë e strategjisë ushtarake të Perandorisë Austro-Hungareze ishte studimi jo vetëm i aspekteve ekonomike, por edhe traditave e zakoneve të vendasve. Komanda e lartë ushtarake prodhoi një buklet të titulluar *Stuktura tribale, normat dhe zakonet e shqiptarëve*, e gjitha e bazuar mbi punën e Lovro Mihačević.¹³ Puna e At Mihačević-it ishte ndërtuar mbi përshtypjet e një udhëtimi të realizuar një vit para Durham-it në vitin 1907. Në këto përshkrime përfshihej edhe një pjesë e mirë e Kosovës.¹⁴ Po ashtu kemi edhe “Ekspeditën për studimin e arteve, etnografisë, arkeologjisë dhe gjuhësisë, në zonat e pushtuara perandorake dhe mbretërore në Serbi, Mal të Zi dhe Shqipëri” të vitit 1916, së cilës i printe Artur Haberlandt, që, po ashtu, mblodhi të dhëna në Kosovë.¹⁵ Shkollat e rajonit, sidomos ato që u morën me Kosovën, ishin të ndërtuara mbi pikëpamjen antropogjeografike, gjithnjë në shërbim të nacionalizmit etnik. Bozhidar Jezernik e ka analizuar mjaft mirë përdorimin politik të kësaj imagjinate politike, që në fakt është një derivat i mendimit antropologjik, analizuar, po ashtu, nga autorë të tjerë në rang universal. (Jezernik 2003)

Në vazhden e këtyre pikëpamjeve kemi edhe një studim, po prapë racial, të kryer në kohën e Luftës së Parë Botërore në territoret e pushtuara

¹² Për një pasqyrë të shumicës së këtyre shkrimeve shih:

<http://www.albanianhistory.net>, të cilën e ka përpiluar Robert Elsie, konsultuar për herë të fundit më 25 maj 2020].

¹³ Shih: At Lovro Mihačević, “Stammesgliederung, Sitten und Gebräuche der Albaner, Armeeeoberkommando (Broschüre),” in *K4*, Zu K.-Nr. 23759. Marrë nga: Marchetti 2010, 219.

¹⁴ Lovro Mihačević, *Durch Albanien: Reise-Eindrücke*, Prague: Bonifatius 1913, f. 153-172. Së fundi, libri është përkthyer edhe në gjuhën shqipe. Shih: Mihačević, Lovro. 2006. *Nëpër Shqipëri: mbresa udhëtimi & etnografi (1883-1907)*. Lezhë: Gjergj Fishta.

¹⁵ Shih: Marchetti 2010: 207-230.

nga Bullgaria, përfshirë edhe një pjesë të mirë të Kosovës. Ky studim është realizuar nga antropologu fizik bullgar Dronchilov. Në këtë studim përfshihen 500 maqedonas dhe 100 shqiptarë. Ndërsa shqiptarët liheshin thuajse jashtë analizës, shprehej droja nëse ata përbënin apo jo një grup etnik nisur nga cilësitë fizike, ndërsa për maqedonasit, edhe pse kishte diversitet në mes cilësive që ata mbartnin, nuk vihej në dyshim se kjo popullatë ishte e një trangu me atë bullgare, pikërisht siç ishte harta simbolike e politikës në Bullgarinë e kohës (Promitzer 2014, 160; Promitzer 2011, 44-63). Ndërkohë që Dronichilov-i ishte duke kryer studimin e tij, në Shqipëri dhe Kosovë, në territoret e zotëruara nga Austro-Hungaria, bëheshin kërkime, përkatësisht nga Arthur Haberlandt dhe Viktor Lebzelter.¹⁶ Në anën tjetër, në vitin 1941 udhëpërshkruesja dhe shkrimtarja britanike Rebecca West boton librin e saj *Black Lamb and Grey Falcon: A Journey through Yugoslavia* (West 1941), që bëhet një prej lamenteve më të njohura në gjuhën angleze për Serbinë dhe “betejën e Kosovës” (1389), që pati ndikim në imagjinatën politike evropiane të kohës.

Gjatë kësaj kohe, në Shqipëri kemi sythe etnografike që vinin si reagime ndaj shkollës serbomadhe dhe botoheshin në revistat e kohës,¹⁷ përfshirë ndonjë përshkrim të vendit të tyre, që vinte nga mësues të Kosovës, kryesisht ata që kishin mbaruar Normalen e Elbasanit. Këtu mund të përmendet një prej tyre që është libërthi i vogël *Fisi i Vokshit* (1931) nga Mehmet Vokshi, botuar në Tiranë (Vokshi 1931) Pa dyshim se në kohën e dhunës, konventës për shpërnguljen jugosllave-turke (1938), e kolonizimit masiv të Kosovës me serbë e malazezë, shqiptarët, në shumicë analfabete, nuk na kanë lënë shkrime mbi gjendjen e tyre, as politike dhe as kulturore. Si u cek më lart, shkrimet me elemente etnografike të argumentit rilindas

¹⁶ Haberlandt, Arthur dhe Viktor Lebzelter. 1919. “Zur physischen Anthropologie der Albanesen,” *Archiv für Anthropologie* 17: 123–154. Për teknikën e matjeve të përhapura gjerësisht në këtë periudhë kohore në kampet ushtarake, nën përdorimin e termit “racë” në vend të termit “kombe” apo popuj shih: Berger 2010, 233-253.

¹⁷ Kujtojmë këtu vetëm titujt e revistës *Leka*, në të cilët shkruhej: “Shqiptarët nuk janë barbarë apo semi-barbarë”, “Cubnija në Shqipëri”, “Vështrimi i gjakmarrjes, kultura e qytetnimit”, “Shpirti përparimtar i shqiptarit”. Shih: *Leka*. 1944. “Të drejtat e Shqipërisë etnike”, Shkodër: “Zoja e Papërlyeme”. Shih: Koleksionet Digjitale BKSJ, konsultuar për herë të fundit më 20 dhjetor 2020.

botoheshin në revista në qytetet e Shqipërisë dhe jashtë vendit në revistat e njohura të shqiptarëve në diasporë.

Për historinë e mendimit etnografik shqiptar është me interes të shënojmë se edhe Rrok Zojzi - themeluesi i Sektorit Etnografik në Shqipëri, më 1947 - kishte bërë një udhëtim nëpër Kosovë dhe kishte botuar dy-tre shkrime modeste me shënime etnografike, te seria që ai e quajti *Kosova Pittoresca*.¹⁸ Vërtetë *Kosova Pittoresca* do të mund të shndërrohej gradualisht, në një *Kosova Etnografica*, por, për fat të keq, Zojzi dhe as studiues të tjerë nga Shqipëria nuk u lejuan që të kryejnë studime të tyre etnografike deri në fillim të viteve '70 të shekullit të kaluar. Zojzi nuk bëri dot më kërkime etnografike në Kosovë as në fund të viteve '70, sepse ai tashmë kishte dalë në pension. Në studimin e tij kryesor mbi ndarjen krahinore të popullit shqiptar, shkrim bazë i tij (1962), mbron tezën që popullsia e krahinës së Dukagjinit ruan në kujtesën e saj faktin se të parët e tyre e kanë origjinën nga fusha, "përkatësisht nga Rrafshi i Dukagjinit". Më tej vijon me analizën e traditave që, sipas Zojzit, përkrijnë më shumë me ato të fushës së Rrafshit të Dukagjinit se sa me ato të Malësisë. (Zojzi 1961, 35)

Etnologjia e Kosovës: periudha jugosllave

Pas Luftës së Dytë Botërore, gjegjësisht prej vitit 1945 e deri në fund të viteve '60-të, Kosova ishte pothuajse e paralizuar nga brutaliteti shtetëror, përkatësisht nga regjimi jugosllav, që në Kosovë dirigjohej nga Aleksandër Rankoviç, Ministër i Punëve të Brendshme (1946-1953) dhe zëvendëskryeministër (1963-1966). Pa dyshim, kjo periudhë meriton më shumë diskutim, por ajo që duhet theksuar është se me gjithë represionin shtetëror të këtyre viteve mbi shqiptarët e Kosovës, disa nga institucionet kryesore që vazhduan të ekzistojnë, u krijuan në atë periudhë, ndër to edhe Instituti Albanologjik (1953), Muzeu i Kosovës (1949)¹⁹ siç quhej atëherë,

¹⁸ Rrok Zojzi. "Fiset e Kosovës", *Tomorri i vogël*, nr. 13, 1942, fq. 6. Rrok Zojzi "Kosova pitoreske – Zhljebi", *Tomorri i vogël*, nr. 2, 1942, fq. 6, Shih edhe: Bardhoshi dhe Lelaj, 2018.

¹⁹ Shkodra 2020, 42. Më pas u krijuan edhe disa muze të tjerë etnologjikë, si: i Mitrovicës, i Prizrenit, i Gjakovës. Muzeu i Kosovës pati edhe *Buletinin*, revistën e vet botuese, ku dhe u botuan shkrimet e para etnologjike nga studiues nga Kosova

dhe Fakulteti Filozofik (1960), që më vonë u bë bërthama e Universitetit të Prishtinës, që u krijua më 1970. Pa dyshim se këto institucione patën peripecitë e veta, siç qe rasti me Institutin Albanologjik që u mbyll më 1955 dhe u rihap më 1966, pas Plenumit të Brionëve.²⁰ Por, shqiptarët e Kosovës filluan t'u qasen edhe shkollave të Jugosllavisë për të kryer studimet e tyre. Kështu, shqiptarët filluan të shkruajnë një etnologji mbi veten në mënyrë zyrtare dhe të institucionalizuar pas Luftës së Dytë Botërore. Numri i etnologëve shqiptarë në institucione qe krejt i vogël, por të gjithë qenë të shkolluar jashtë Kosovës, përkatësisht në Beograd, Zagreb e Lubjanë.

Studiuesit e parë shqiptarë që kryen shkollën në lëmin e etnologjisë janë Kadri Halimi dhe Mark Krasniqi. Kadri Halimi mbaroi studimet për etnologji në Universitetin e Beogradit. Që nga vitet e tij si student e deri sa u arrestua për herë të dytë (1961), Halimi kishte mbledhur vazhdimisht të dhëna etnografike mbi kanunin, poezinë popullore, mbi fiset, artizanët e tema të tjera, pjesë e interesit të tij etnologjik. (Halimi-Statovci 2011) Vepra e tij është përmbledhur dhe botuar në 5 vëllime nga IAP me redaktore Drita Halimi-Statovci. (Halimi 2011)

Duke kaluar nëpër procese burgosjeje e keqtrajtimi, ai ka pësuar si etnolog. Shumë prej projekteve të tij kërkimore janë ndërprerë kohë pas kohe, materialet arkivore i janë konfiskuar, i është ndaluar të ushtrojë profesionin e tij. Punën e ka nisur me një punim diplome mbi Kanunin e Lekë Dukagjinit, por më vonë ka vijuar punën e tij në shumë tema të tjera. Në vija të përgjithshme, lënda që ka marrë vëmendjen e Halimit, shtrihet nga ajo etnografike, por edhe folklorike, duke e parë këtë të fundit në funksion më shumë të etnologjisë apo, të themi, më shumë tek aftësia krijuese dhe artistike e një shoqërie.

Mark Krasniqi kreu studimet në degën e letërsisë në Universitetin e Padovës, Itali. Në vitet 1946-1950 kreu studimet në Universitetin e Beogradit për gjeografi-etnografi. Rreth 11 vite punoi si asistent shkencor në Akademinë e Shkencave të Beogradit, ku u pengua të mbronte tezën e

për Kosovën, në një organ shtypi në Kosovë, por në serbisht. Shih: Krasniqi 2020, 117-130.

²⁰ Për më shumë rreth historikut shih: <http://www.institutalbanologjik.com/>, konsultuar për herë të fundit më 7 maj 2020.

doktoratës. Më pas kreu studimet doktorature në Universitetin e Lubjanës, në 1960. (Krasniqi 2012) Nga viti 1960 e në vijim, Mark Krasniqi angazhohet në mësimdhënie dhe kërkime shkencore në lëmin e etnologjisë dhe gjeografisë në Prishtinë. Nga puna e Krasniqit kemi një seri artikujsh studimorë, disa monografi dhe përmbledhje studimesh.²¹ Kur analizohet puna e Mark Krasniqit, vërehet se e shquajnë dy aspekte: polemika me nacionalizmin borgjez serb dhe studimi i kulturës në kontekst të arealit kombëtar shqiptar, nën hijen e mendimit evolucionist, antropogjeografik dhe të materializmit dialektik. Temat e veprës së Krasniqit janë të larmishme, prej studimit të një krahine specifike (Rugova) deri te temat e ndryshme me fokus ndarjen krahinore të Kosovë, shtëpinë e madhe, familjen, besimet, kullat, kishat ortodokse, artin popullor etj.²² Por, sikurse shihet te shumica e veprave të etnologëve shqiptarë që kanë vepruar në Jugosllavi, edhe te Mark Krasniqi vërejmë tiparin e pashmangshëm të rekomandimit për të ndryshuar gjërat në drejtim të përsosjes së zhvillimit të shoqërisë sipas doktrinës planifikuese shtetërore, krahas atij të ruajtjes dhe bartjes së vlerave popullore që shquajnë popullin si etni.

Puna në lëmin e etnologjisë u vijua edhe nga etnologë të tjerë, një brez i ri si studiuesit Ukë Xhemaj, Drita Halimi-Statovci, Bashkim Lajçi e disa të tjerë. Studimet e brezit të dytë erdhën përsëri në një kohë të vështirë politike. Fillimisht, koha kur këta studiues e kanë nisur punën kërkimore kishte një atmosferë lirie të mendimit dhe investime shtetërore në krijimin e institucioneve të arsimit dhe kërkimit shkencor në Kosovë. Kosova kishte marrë statusin e Krahinës Autonome (1974) dhe për pak kohë u ndërtuan katedra dhe qarkulluan ide, projekte kërkimore si dhe doli një klasë e re intelektuale, e cila do të luante rolin kryesor në sferën e dijes, kulturës dhe politikës. Por kjo periudhë u ndërpre shpejt pas valës së ndryshimeve që erdhën pas vdekjes së Titos, të ndërthurura me ngritjen e nacionalizmit dhe krizave ideologjike dhe ekonomike në ish-Jugosllavi. Nga materialet

²¹ Krasniqi 1979; 1984; 1987; 1991. Shih edhe: Krasniqi 1977, 111-120. Po ashtu, Mark Krasniqi ka qenë edhe poet i njohur, sidomos për fëmijë, dhe përkthyes pedant i disa veprave.

²² Për një vështrim kritik të punës së Krasniqit për ndarjen krahinore dhe një vështrim më të plotë për kufirin ndërkrahinor shih: Çoçaj 2014.

etnografike del se puna kërkimore kishte nisur që në vitin 1976, ku Ukë Xhemaj ushtroi kërkime etnografike në krahinën e Podgurit, por botimi i kësaj monografie do të ndodhte në vitin 2003.²³ Drita Statovci-Halimi iu kushtua më shumë kulturës materiale, përfshi zejtarinë dhe artizanatin popullor, por edhe tema të tjera prej ushqimit e deri ndihmat e solidariteti.²⁴

²³ Shih disa nga shkrimet: Xhemaj, Ukë. 2003. *Etnokultura shqiptare në Podgur*, Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës; Xhemaj, Ukë. 1989. *Mbijetojat arkaike në strukturën dhe organizimin e familjes shqiptare në Kosovë*; Xhemaj, Ukë. 1979. “Reliktet e besimeve pagane e totemike në Opojë e Gorë”. *Gjurmë e gjurmime: seria folklor-etnologji*, nr. 9: 99-112; Xhemaj, Ukë. 1983. “Relikte të kultit të gjarprit në traditën popullore shqiptare”. *Gjurmime albanologjike: seria folklor - etnologji*, nr. 13: 23-33; Xhemaj, Ukë. 1984. “Për disa çështje rreth kuvadës ndër shqiptarë”. *Gjurmime albanologjike: seria folklor - etnologji*, nr. 14: 129-141; Xhemaj, Ukë. 1985. “Riti i thirrjes së shiut dhe riti i ndaljes së breshrit”. *Gjurmime albanologjike: seria folklor - etnologji*, nr. 15: 27-40; Xhemaj, Ukë. 1986. “Gjurmë animizmi në besimet rreth drunje”, *Gjurmime albanologjike: seria folklor - etnologji*, nr. 16: 99-105; Xhemaj, Ukë. 1988. “Rite motmoti dhe besime të tjera mitologjiko-agrare në Kosovë”, *Gjurmime albanologjike: seria folklor - etnologji*, nr. 18: 7-26; Xhemaj, Ukë. 1989. “Mbijetojat arkaike në strukturën dhe organizimin e familjes shqiptare në Kosovë”, *Gjurmime albanologjike: seria folklor - etnologji*, nr. 19: 153-169. Xhemaj ka botuar edhe përmbledhjen: Xhemaj, Ukë. 2005. *Shtresime kulturore*, Prishtinë: IAP.

²⁴ Statovci-Halimi, Drita. 1982. *Zhvillimi i zejtarisë dhe rëndësia e saj bashkëkohore për strukturën ekonomike –shoqërore të KSA të Kosovës*, Prishtinë: IAP; Halimi-Statovci, Drita. 1981. “Shënime nga mjekësia popullore në tri treva të Kosovës”. *Gjurmime albanologjike*, seria folklor etnologji nr. 10: 59-68; Statovci, Drita. 1982. “Shqyrtime rreth organizatave zejtare”, *Gjurmime albanologjike*, seria folklor-etnologji nr. XI-1981: 61-75; Statovci, Drita. 1986. “Disa udhëpërshkrime angloamerikane mbi pozitën e gruas shqiptare”. *Gjurmime albanologjike*, seria folklor-etnologji nr. 16-1: 63-70; Statovci, Drita. 1984. “Skicë për studimin e ushqimit popullor”. *Gjurmime albanologjike*, seria folklor-etnologji nr. XIII-1983: 131-140; Halimi-Statovci, Drita. 1995. “Mbi përkujtimet”. *Gjurmime albanologjike*, seria folklor-etnologji, nr. 24-1994: 53-74; Halimi-Statovci, Drita. 1996. “Disa veshje shqiptare në Mal të Zi”. *Gjurmime albanologjike*, seria folklor-etnologji, nr. 25-1995: 61-82; Halimi-Statovci, Drita. 2004. “Mendësi dhe besime popullore për shtëpinë”. *Gjurmime albanologjike*, seria folklor-etnologji, nr. 31-2001: 91-110. Shih edhe përmbledhjet e shumicës së eseve:

Pas luftës, studimet e Drita Halimi-Statovcit vijnë kryesisht mbi veshjet e dukuri të tjera të kulturës materiale.²⁵ Në të njëjtën frymë, Bashkim Lajçi vijon studimet mbi armët nga konteksti historik, por edhe studimet etnologjike mbi aspekte të dokeve e zakoneve, si veshjet, tabutë, martesat etj.²⁶

Qasja teorike e studimeve etnologjike si për brezin e parë dhe të dytë, dominohet nga ajo historiciste albanologjike, e dominuar nga imagjinata evolucioniste dhe me gjuhë që ka për qëllim emancipimin e shoqërisë, por edhe mbrojtjen e saj. Mbrojtja konsiston ndaj mënyrës se si e ka parë etnologjia borgjeze serbomadhe, ose nga shteti serbomadh dhe aty-këtu, por në mënyrë shumë herë më të përmbajtur se, ta zëmë, etnologjia në Shqipëri, etnologët shprehen për nevojën për emancipim të shoqërisë. Këtë nevojë për t'u shprehur e evitojnë edhe duke mos u marrë shumë me të tashmen socialiste. Studime të tjera priten për të nxjerrë në dritë më tej zhvillimin e mendimit etnologjik në Kosovë. Për studimet të cilat kishin gjykuar

Statovci-Halimi, Drita. 1988. *Kërkime etnografike*. Prishtinë: Rilindja; Halimi-Statovci, Drita. 1998. *Etnologjia flet*. Prishtinë: IAP.

²⁵ Shih: Halimi-Statovci, Drita. 2009. *Veshjet shqiptare të Kosovës*, Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës; Halimi-Statovci, Drita. 2013. *Nga djepi në përjetësi*. Prishtinë: IAP; Halimi-Statovci, Drita. 2018. *Pikturimi i fytyrës në Kosovë ndërmjet traditës dhe modernitetit*. Prishtinë: Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

²⁶ Shih disa nga punimet: Lajçi, Bashkim. 1994. "Funksioni i veshjes në besimet popullore shqiptare". *Gjurmime albanologjike*, seria folklor-etnologji, nr. 23-1993: 187-192; Lajçi, Bashkim. 2001. "Tabuizimi i emrave në Rugovë". *Gjurmime albanologjike*, seria folklor-etnologji, nr. 28-29/1998-1999: 141-147; Lajçi, Bashkim. 2002. "Martesa në traditën tonë popullore". *Gjurmime albanologjike*, seria folklor-etnologji, nr. 32-2002: 133-142; Lajçi, Bashkim. 2007. "Motivet astrale në ornamentikën tonë popullore". *Gjurmime albanologjike*, seria folklor-etnologji, nr. 36-2006: 233-240; Lajçi, Bashkim. 2008. "Mbi disa mënyra të mbrojtjes nga syri i keq". *Gjurmime albanologjike*, seria folklor-etnologji, nr. 37-2007: 255-275; Lajçi, Bashkim. 2011. "Funksioni i armës në doket e zakonet tona popullore". *Gjurmime albanologjike*, seria folklor-etnologji, nr. 40-2010: 141-148. Po ashtu, Lajçi boton edhe disa monografi: Lajçi, Bashkim. 2007. *Gjurmime etnologjike*. Pejë; Lajçi, Bashkim. 2013. *Syri i keq në besimet shqiptare*, Prishtinë: IAP; Lajçi, Bashkim. 2014. *Tabu në etnokulturën shqiptare*, Prishtinë: IAP.

shqiptarët në pikëpamje raciste apo të së padrejtës, etnologët shqiptarë në Kosovë i klasifikonin, ashtu siç bënin dhe kolegë të tjerë socialistë, duke i quajtur ata borgjezë, një diskualifikim marksist i kohës. Kështu vepronin edhe për padrejtësitë e shtetit borgjez dhe aplikimin e politikave të tyre kolonializuese, shfarosëse (gjenocidale) gjatë kohës para periudhës socialiste. Duke ndjekur një qasje historiciste, edhe pse kërkimi etnografik realizohej në periudhën socialiste, kontributet etnografike për jetën gjatë kësaj periudhe mungojnë thuajse tërësisht në Kosovë. Në mbyllje të disa studimeve hidhet vështrimi për të tashmen socialiste si një formë mbylljeje, si “një kapërcyell” a “ndërmjetëz”, një formë ftese, por tezat nuk zhvillohen më tutje. Sikurse të kishim të zhvilluara këto skaje etnografike, do të kishim më tepër të dhëna për të tashmen apo të atëhershmen socialiste të kulturës tradicionale.²⁷

Organi kryesor ku janë botuar rezultatet dhe të dhënat etnografike është revista *Gjurmime albanologjike* (që nga vitit 1962) dhe specifikisht seria e saj *Folklor-etnologji* (që nga viti 1970).²⁸ Veç autorëve që zëmë në gojë, jo pak autorë nga fusha të ndryshme kanë kontribuar me studime që lidhen ngushtësisht me lëmin e etnologjisë. Ndër ta shquhen folkloristë dhe studiues të së drejtës zakonore. Ajo që vërehet te studimet etnologjike të realizuara nga etnologët kosovarë për veten e tyre është paraqitja e kulturës popullore si pjesë e mozaikut kulturor shqiptar, promovimi i diversitetit të varianteve brenda krahinave apo “zonave etnografike”, si pjesë të pashmangshme të kulturës kombëtare shqiptare dhe rekomandimeve që, herë pas here, ata japin për përparimin e shoqërisë.

²⁷ Një ftesë hyrëse për studimin e etnologjisë kosovare është dhënë në kumtesën e Arsim Canollit: “Dy raste studimore mbi temat, qasjet, dhe variantet e studimit etnografik/etnologjik në Kosovë”, në konferencën V të studimeve etnologjike: “Pasiguritë e etnologjisë shqiptare”, të organizuar nga Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit, Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 18-19 dhjetor 2017. Autori është duke vazhduar studimin mbi mendimin etnologjik të Mark Krasniqit në kuadër të studimit mbi etnologjinë në Kosovë dhe mbi Kosovën.

²⁸ Një numër shkrimesh etnologjike dhe muzeologjike botohen në revista si: *Përparimi, Jeta e re* etj. Po ashtu, *Buletini i Muzeut të Kosovës*, themeluar më 1956, botoi shkrime etnologjike deri më 1988. Shih: Shkodra 2020, 42.

Nga ana tjetër, kërkimi antropologjik në Jugosllavinë socialiste ushtrohet edhe nga kërkues të huaj. Kjo ndodh, të paktën, që prej mesit të viteve '50 të shekullit XX (Halpern 1956; Lockwood 1975). Një fakt i tillë është i lidhur me pozicionin ideologjik dhe politik, atë të të painkuadruarit, që mbajti Jugosllavia gjatë Luftës së Ftohtë. Një fakt i tillë ndikoi thellësisht në të gjitha trajektoret e mendimit që mori antropologjia dhe etnologjia në këtë vend (Halpern 1969, 17-26).

Një numër i konsiderueshëm autorësh, vendas dhe të huaj, sidomos pas viteve '60-të, filluan të merrnin pjesë në debatin antropologjik ndërkombëtar. E një pjesë e mirë e studimeve, sidomos ato realizuar nga studiues të huaj, kishin objekt të tashmen socialiste. Një të tashme socialiste në të cilën përfshihen tema klasike antropologjike si, fjala vjen, studime mbi fisninë, familjen (zadrugën), ritualet, por edhe tema konkrete të së tashmes socialiste siç ishin ndryshimet e jetës në fshat, efektet e industrializimit e kështu me radhë.²⁹ Megjithëse janë bërë studime historike dhe kritike mbi mendimin antropologjik e etnologjik në Jugosllavi, ende nuk kemi ndonjë studim që t'i nënshtrohet pyetjes se përse kërkimet antropologjike ndërkombëtare nuk rrokin Kosovën deri në fund të viteve '70-të. Kosova i plotësonte kushtet nga çdo pikëpamje për të kapur kureshtinë antropologjike, por ajo nuk përmendej thuajse fare. Kjo kureshti jehon edhe në kujtimet e përvojës së Mary Motesit, një mësuese e gjuhës angleze në Prishtinë, e cila kishte zbarkuar në vitin 1966 dhe kishte jetuar atje vite me radhë, duke u kthyer herë pas here. Kur që takuar me një kamerier/pritës shqiptar në Beograd, para se të shkonte në Prishtinë, ajo ishte ngazëllyer dhe këtë e thotë si kujtesë të dijes që ka pasur deri atëherë: "E dija se shqiptarët ishin delja e zezë e Ballkanit. Në Kosmet numri i tyre ishte shumë i madh, sepse i kishin dëbu serbët e krishterë. Ata ishin të krishterët e Ballkanit që ishin "kthi në turq". (Motesi 2017, 21) Kjo dëshmi e Motesit shënjon mënyrën sesi ka punuar propaganda akademike dhe politike serbe kundër shqiptarëve. Pyetja shtrohet: a nuk përbën kjo një kureshtje tipike për të njohur këtë popull? Por kjo mund të na cytë të mendojmë se ndoshta

²⁹ Për debatin mbi të tashmen dhe të shkuarën në etnologji brenda mendimit jugosllav, shih debatin mes Spiro Kulisić dhe Milenko Filipović, në fillimet e viteve '50-të, shek. XX, te: Goranović 2008, 307-336.

gjithë interpretimi duhet të nisë nga fakti se gjatë viteve '50-të dhe '60-të, Kosova mbahej krejtësisht nën heshtje, gjatë së cilës ushtrohej represioni serbomadhbrenda Jugosllavisë, pasi gjatë atyre kohëve, deri në Plenumin e Brionëve (1966), në Kosovë mbizotëronte ajo që në popull mbahet mend e kujtohet si “koha e Rankoviçit”.³⁰

Kosova shfaqet në sytë e antropologjisë botërore në vitet '70-të e këtej. Këtë e përbëjnë studimet e Berit Backer-it dhe Janet Reineck-ut dhe, pak më vonë, të studiuesit Ger Duijzing. Studimet e ndërmarra nga këta tre përbëjnë një ndryshim themelor, sepse janë punë kërkimore në lëmin e antropologjisë, nga studentë e studiues që vijnë nga universitete perëndimore. Ardhja në Kosovë në këtë kohë e këtyre tre studiuesve shënon një kthesë historike në studimet antropologjike jo vetëm për Kosovën, por edhe për shqiptarët në tërësi. Berit Backer para se të vendoste të kryente kërkimet etnografike në Kosovë, më parë kishte dashur të studionte kanunin në Shqipërinë e Veriut, por nuk ishte lejuar. Më pas vendosi që projektin e saj ta zhvillonte në fshatin Isniq të Kosovës. (Backer 2003) Ndoshta ky fshat u zgjodh për shkak të përshkrimeve etnografike, që kishte realizuar më parë Edith Durham-i në *High Albania*. Ndërsa Janet Reineck zgjodhi një krahinë tjetër, Opojën.³¹ Teza të kësaj studiueseje, si, ndër të tjera, vijimi i traditës, ndarja e punës, raportet e familjes dhe emigracioni, përbëjnë kuriozitet e janë përfshirë në analiza dhe shqyrtime nga studiues të tjerë që janë marrë me Kosovën dhe rajonin. Një peshë specifike i kushtohet mënyrës se si instrumentalizohet apo vijohet tradita duke iu referuar së shkuarës. Në vitet '80-të, Ger Duijzing, i trajnuar në antropologji sociale, fillon punën kërkimore në Kosovë e më specifikisht në fshatin Letnicë, një fshat në zonën e Karadakut të Kosovës, në kufi me Maqedoninë e Veriut. Duijzing përdori të dhënat etnografike, mbledhur në

³⁰ Pothuajse në shumicën e 100 intervistave me të moshuar mbi 80 vjeç në Kosovë përmendet “koha e Rankoviçit” si kohë e dhunës sistematike. Shih: Canolli 2019, 19-26

³¹ Reineck, Janet. 1991. *The Past as Refuge: Gender, Migration and Ideology among Kosovo Albanians*. Tezë doktore. University of California.

https://www.esiweb.org/pdf/kosovo_reineck_dissertation.pdf , konsultuar për herë të fundit më 12 dhjetor 2020.

këtë fshat, për të dialoguar mbi çështje që po ktheheshin në tabu, siç ishte fluiditeti i identiteteve kombëtare, vendet e shenjta të përbashkëta, qofshin këto dhe në numër të vogël, në mes shqiptarëve, serbëve, kroatëve, romëve e kështu me radhë. Secili nga autorët ndryshon në qëndrimet e tyre dhe në analiza, por ata së bashku krijuan një trekëndësh vëzhgimesh antropologjike mbi Kosovën ndër vitet më delikate, prej nga rrodhën apo hodhën bazat ndryshimet sociale, ekonomike e politike në Kosovë dhe gjithë ish-Jugosllavinë. Megjithëse këta autorë duket se kanë pasur njohje personale me studiuesit vendas të etnologjisë, asnjë punë e tyre nuk vjen si referencë në etnologjinë vendëse deri në vitet e fundit, me ardhjen e antropologëve të brezit të tretë, pas luftës së Kosovës më 1998-1999.

Fundi i periudhës së etnologjisë kosovare nën regjimin jugosllav shënjohej me konferencën apo sesionin shkencor të Institutit Albanologjik të Prishtinës “Studimi etnografik i ndryshimeve bashkëkohore në kulturën popullore shqiptare”, që u mbajt më 7-8 dhjetor të vitit 1989.³² Ndonëse në vitin 1979 qe mbajtur një konferencë mbi traditën dhe trashëgiminë popullore, si një lloj vazhdimi i konferencës etnografike në Tiranë e mbajtur më 1976³³, sesioni i vitit 1989 sjell në pah pikërisht fundin e etnografisë së Kosovës gjatë periudhës jugosllave. Por, pikërisht ai vit shënjon abrogimin e autonomisë së Kosovës dhe nisjen e refuzimit politik të shqiptarëve përmes krijimit të pluralizmit politik dhe rezistencës paqësore. Botimi nga konferenca sjell një sërë esesh, të së njëjtës frymë, me ndonjë ndryshim, që kishte përshkuar etnografinë gjatë dekadave të mëparshme.

Vitet '90-të dhe lufta

Gjatë viteve '90-të pati një heshtje të etnologjisë në Kosovë. Uzurpimi i institucioneve, mungesa e një katedre të etnologjisë, nevoja për të mbijetuar gjatë një dekade mjaft turbulluese e shumë pengesa të tjera nuk premtuan që studimet etnologjike të riorganizoheshin apo të hapeshin në

³² Shih: Halimi-Statovci, Drita (përgj.). 1990. *Studim etnografik i ndryshimeve bashkëkohore në kulturën popullore shqiptare. Material nga sesioni shkencor i mbajtur në Prishtinë më 7 dhe 8 dhjetor 1989*. Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës.

³³ Shih: *Trashëgimia dhe transformimi i kulturës popullore: materiale nga sesioni shkencor, mbajtur në Prishtinë më 7-8 shtator 1979*. Prishtinë: IAP. Botuar më 1983.

shtigje të reja. Brezi i dytë ishte një grup i vogël etnologësh që, herë pas here, i gjen në letrat e viteve '90-të, me ndonjë shkrim aty-këtu në revistën *Gjurmime albanologjike*, seria folklor-etnologji. Por, gjatë kësaj kohe, Mark Krasniqi vjen me disa shkrime të përmbledhura nën titullin *Nga gurra e traditës*. (Krasniqi 1991) dhe me një vepër mjaft solide në diskutimin etnologjik mbi religjion, siç është ajo e quajtur *Aspekte mitologjike: besime e bestytmi*, (Krasniqi 1997) e botuar më 1996. Drita Halimi-Statovci, po ashtu, boton veprën e saj *Etnologjia flet*, një përmbledhje e shkrimeve të saj. (Halimi-Statovci 1998) Gjatë kësaj kohe vërehen edhe shkrime në revistat javore e gazetat ditore.

Lufta në Kosovë, e paraprirë nga lufta në Kroaci e sidomos në Bosnjë-Hercegovinë, solli një debat shumë të gjallë midis studiuesve në përgjithësi, ku morën pjesë edhe antropologët. Teori e qasje të ndryshme teorike dhanë kontribute me shumë vlerë mbi kapacitetin e antropologjisë për të kuptuar më tej. Nga ana tjetër, në Kosovën e pushtuar nga Serbia, ku mbretëronte rezistenca paqësore kundër dhunës e represionit të Serbisë, e paprecedentë në Ballkan, pati edhe raste kur u diskutua origjina e dhunës etno-nacionaliste serbe. (Krasniqi 1995, 7-19) Për të mos hyrë më tutje, vlen të theksohet se një diskutim të thukët mbi etno-nacionalizmin serb gjatë viteve '90 e bën antropologu serb Marko Živković. (Živković 2011)

Etnologjia shqiptare, me përjashtim të ndonjë përçapjeje për të dokumentuar ndonjë të dhënë mbi kampet e refugjatëve, nuk u përfshi drejtpërdrejt në debatin teorik e etik, që u zhvillua në antropologjinë botërore lidhur me çka po ndodhte në ish-Jugosllavi e as në Kosovë. Është me interes të thuhet se në fund të viteve '70-të, kohë kur Shqipëria shkëputi marrëdhëniet me Kinën dhe kaloi në periudhën e izolimit total, filloi bashkëpunimi mes Shqipërisë dhe Kosovës, në kuadër të bashkëpunimit institucional të lejuar nga Jugosllavia. Gjatë kësaj kohe u zhvillua një ekspeditë kërkimore në Kosovë. Ekspedita u realizua në vitin 1979, sipas metodës së punës në grup me fokus mbledhjen e traditës, me studiues nga Instituti i Kulturës Popullore në Tiranë dhe kolegë të etnografisë dhe folklorit nga Institutit Albanologjik dhe Universiteti i Prishtinës. Për fat të keq studiuesit nuk na kanë lënë shënime të përshtypjeve të tyre gjatë kryerjes së kërkimit etnografik në kushte kaq specifike. Etnografi i Shqipërisë do të mund të rikthehej në Kosovë vetëm pas luftës. Rikthimi

ndodhi në dy momente (1999, 2001). Njëri ishte me qëllim vijimin e punës së nisur në kampet e refugjatëve në Shqipëri gjatë luftës dhe, më pas, në kuadër të një projekti për zonën e Hasit, si një zonë etnografike në dy anët e kufirit.

Kosova antropologjike pas luftës

Siç theksuam në fillim, pas mbarimit të luftës së vitit 1999, Kosova u shndërrua në një vend ku pati studime të ndryshme. Si kurrë më parë, në debat u përfshinë intelektualë e figura të ndryshme publike që, pavarësisht animeve të kaheve politike konservatore apo progresive, argumentuan ngulmas edhe pro, edhe kundër “intervenimit” të NATO-s në Kosovë.

Në kontekstin lokal, menjëherë pas luftës, etnologët e Prishtinës patën dy qendra. Përveç se në Institutin Albanologjik të Prishtinës, ku ishte dega e etnologjisë që nga vitet ’70-të, etnologët u mbledhën edhe rreth një vatre të re që krijuan në Universitetin e Prishtinës, Departamentin e Etnologjisë, më 2002. Ishin pikërisht etnologët e Institutit ata që krijuan Departamentin e Etnologjisë. Drita Halimi-Statovci dhe Ukë Xhemaj u bënë profesorët kryesorë të studentëve të parë të etnologjisë. Në këtë departament nisi mësimdhënia e etnologjisë nga etnologët e brezit të dytë, por edhe me profesorë të historisë, etnomuzikologjisë, sociologjisë e, herë pas here, edhe me profesorë vizitorë nga Shqipëria, Sllovenia e vende të tjera. Konsiderohet se diku rreth 300 studentë janë diplomuar nga 15 gjenerata të këtij departamenti, që në vitin 2014 u shndërrua në Departament të Antropologjisë me dy drejtime: “antropologji kulturore” dhe “arkeologji”.³⁴

Në dy dekadat e fundit, sidomos në më të fundit, ka një sërë studimesh antropologjike, realizuar nga studiues të vendeve të ndryshme dhe të një breznie të re antropologësh nga Kosova. Këto studime patën në fokus të tyre tema që lidhen me praktikën e ndërhyrjes humanitare, (Pandolfi 2009) me natyrën e shtetit dhe institucioneve ndërkombëtare që po ndërvepronin apo po ndërtoheshin, mbi kombin dhe gjininë, me kulturën buknore në kohë të ndërtimit të shtetit, me pronën, ligjin

³⁴ Shih: *Doracak për studentë 2019-2020*, Prishtinë, Departamenti i Antropologjisë, Fakulteti Filozofik, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, 2019.

dhe lidhnitë sociale, ligjin.³⁵ Gjithashtu kemi pakicat kombëtare dhe pluralizmin ligjor (Bardhoshi 2016), transnacionalizmin e familjen apo lidhjet familjare, pushimet, vendlindjen (Kadriu 2018, 173-193), familjen e fisninë, gjininë e patriarkalitetin,³⁶ emigracionin transnacional,³⁷ mjeshtëri të ndryshme, (Rajković; Geci 2017, 305–330) fisninë dhe sigurinë,³⁸ muzeografinë (Shkodra 2020), kujtesën (Berisha 2017, 35-54), vullnetin politik, vendet e reja të pelegrinazheve,³⁹ subkulturën, (Halimi 2013, 77-84)

³⁵ Luci, Nita. 2014. *Seeking Independence: Making Nation, Memory, and Manhood in Kosovo*. Tezë doktore, Universiteti i Michigan-it.

https://deepblue.lib.umich.edu/bitstream/handle/2027.42/107225/nluci_1.pdf?sequence=1&isAllowed=y, konsultuar për herë të fundit më 20 dhjetor 2020; Canolli, Arsim. 2014. *Behind Open Doors: Restaurants and Food Culture in Kosovo*. Tezë doktore, University College London.

<https://discovery.ucl.ac.uk/id/eprint/1452980/>, konsultuar për herë të fundit më 20 dhjetor 2020. Punë të realizuara në zonën kufitare Shqipëri-Kosovë janë: Bardhoshi, Nebi. 2011. *Gurt e Kufinit: Kanuni, prona, strukturimi social*. Tiranë: Universiteti Europian i Tiranës; Bardhoshi, Nebi. 2013. “Legal Dynamics in Border Area Between Customary Law and State Law”, *Journal of Legal Anthropology*, Vol. 1, nr. 3: 314-332.

³⁶ Shih Luci 2014; Latifi 2014, 203-214; Krasniqi 2011, 99-111; Krasniqi 2015, 191-206.

³⁷ Leutloff-Grandits, Caroline. 2019. “When Men Migrate for Marriage: How Kosovo-Albanian Couples Cope with Gender Stereotypes and Immigration Barriers in Germany and Austria”. *Journal of Ethnic and Migration Studies. Special Issue on Cross-Border Marriages: Intersecting Categories from the Perspective of States, Spouses and Researchers*, përgatitur nga Janine Dahinden, Jowlle Moret dhe Apostolos Andrikopoulos.

³⁸ Leutloff-Grandits, Caroline. 2019. “Kinship and Safety Nets in Croatia and Kosovo”, Bloomington. Në *Everyday Life in Balkans* përgatitur nga David. W. Montegomero: 63-76. Indiana University Press; Latifi, Tahir. 2019. “Generational and intergenerational care and mobility networks in Kosovo”. *Südosteuropa. Journal of Politics and Society*, vol. 67 (2): 196-210; Latifi, Tahir. 2018. “The Culture of Relatedness in Kosovo: The Role of Kinship in the Private and the Public Sphere”, *Studia Ethnologica Croatica*, Vol. 30, nr. 1: 147-168.

³⁹ Schwander-Sievers, Stephanie. 1999. “The Albanian Aromanians' Awakening: Identity Politics and Conflict in Post-communist Albania”, Flensburg, Germany:

European Centre for Minority Issues (ECMI); Schwander-Sievers, Stephanie. 2005. "‘Culture’ in Court: Albanian Migrants and the Anthropologist as Expert Witness". Në *Applications of Anthropology: Professional Anthropology in the Twenty-first Century* përgatitur nga Sarah Pink: 209-228. Oxford - New York: Berghahn Books; Di Lellio Anna dhe Stephanie. Schwander-Sievers. 2006. "The legendary commander: The construction of an Albanian master-narrative in post-war Kosovo". *Nations and Nationalism*, 12 (3): 513-529; Schwander-Sievers, Stephanie dhe Anna Di Lellio. 2006. "Sacred Journey to a Nation: the Construction of a Shrine in Postwar Kosovo". *Journeys: The International Journal of Travel and Travel Writing*, 7 (1): 27-49; Schwander-Sievers, Stephanie. 2009. "Securing Safe Spaces: Field Diplomacy in Albania and Kosovo". Në *Women Fielding Danger: Negotiating Ethnographic Identities in Field Research* përgatitur nga Martha K. Huggins dhe Marie Loise Glebbeek: 173-198. Boulder, New York and Oxford: Rowman & Littlefield Publishers; Schwander-Sievers, Stephanie. 2010. "Invisible - Inaudible: Albanian Memory of Socialism after the War in Kosovo". Në *Post-Communist Nostalgia* përgatitur nga Maria Todorova dhe Zsuzsa Gille: 96-112. New York: Berghahn Books; Schwander-Sievers, Stephanie. 2010. "Between Social Opprobrium and Repeat Trafficking: choices and chances of Albanian women deported from the UK". Në *Trafficking and Human Rights: European and Asia-Pacific Perspectives* përgatitur nga Leslie Holmes: 95-115 Cheltenham: Edward Elgar Publishing; Schwander-Sievers, Stephanie dhe Isabel Ströhle. 2012. "An Ethnography of 'Political Will': Towards a Thick Description of Internal Scripts in Post-War Kosovo". *Südosteuropa*, 60 (4): 497-513; Schwander-Sievers, Stephanie. 2013. "Democratisation through Defiance? The Albanian Civil Organisation 'Self-Determination' and International Supervision in Kosovo". Në *Civil Society and Transitions in the Western Balkans* përgatitur nga Vesna Bojicic-Dzelilovic, James V. Ker-Lindsay dhe Denisa Kostovicova: 95-116. London: Palgrave Macmillan; Schwander-Sievers, Stephanie. 2013. "The Bequest of Illegalja: Contested Memories and Moralities in Contemporary Kosovo". *Nationalities Papers*, 41 (6): 953-970; Schwander-Sievers, Stephanie. 2019. "Longing for lost normalcy: Social memory, transitional justice, and the ‘house museum to missing persons in Kosovo’". *Nationalities Papers*, 47 (2): 232-247; Schwander-Sievers, Stephanie, Linda Gusia, Nita Luci, Lura Pollozhani. 2019. "Fragments on Heroes, Artists and Interventions: Challenging Gender Ideology and Provoking Active Citizenship through the Arts in Kosovo". Në *Post-Participatory’ Arts for the ‘Post-Development’ Era* përgatitur nga Paul Cooke dhe Inès Soria-Dolan: 105-123. London: Routledge.

migrimin e brendshëm, (Canolli 2017, 49-70) ekokulturën (Krasniqi 2017), krahinën e ndarjen krahinore (Çoçaj 2014).⁴⁰ Krahas shkrimit si teknikë kryesore e rrëfimit etnologjik dhe antropologjik për Kosovën, po krijohet gradualisht një traditë e vogël e aplikimit të videos si formë rrëfimi antropologjik dhe, në anën tjetër, ka filluar një studim antropologjik i vizuales.⁴¹ Organi kryesor në gjuhën shqipe për etnologjinë në Kosovë vijon të jetë revista shkencore *Gjurmime albanologjike* – folklor dhe etnologji.⁴²

Po ashtu, nga brezi i ri apo brezi i tretë i etnologëve të Kosovës, kemi një numër monografish a përmbledhje studimesh, të cilat sjellin tema e çështje me shumë rëndësi në lëmin e dijeve antropologjike.⁴³ Tashmë, qasjet janë plurale e me ndërthurje të ndryshme teorike. Por, përsëri në fokus mbetet vetja, pra kultura shqiptare, por parashtruar në një spektër shumë herë më të gjerë krahasues dhe konverzacioni antropologjik botëror. Mund

⁴⁰ Krahas studimit doktoral që në fokus ka analizimin e punës etnografike për ndarjen krahinore, historinë e kërkimit mbi këtë temë etj., Çoçaj ka vijuar kërkimin etnografik mbi tema dhe krahina specifike. Shih p.sh: Çoçaj, Nexhat. 2011. *Hasi Enciklopedi etnokulturore: Gjeografia, trashëgimia familjare, familja, jeta sociale* Prizren: Milleniumi i Ri; Çoçaj, Nexhat. 2011. *Hasi: Ritet e lindjes dhe vdekjes*. Prizren: Milleniumi i Ri; Çoçaj, Nexhat. 2011. *Hasi Enciklopedi etnokulturore: Veshje tradicionale të Hasit*, Prizren: Milleniumi i Ri; Çoçaj, Nexhat. 2011. *Hasi Enciklopedi etnokulturore: Mallkime dhe urime*, Prizren: Melleniumi i Ri.

⁴¹ Canolli, Arsim. 2006. “Filmi etnografik: Një pamje e shfaqjes dhe e zhvillimit të tij”. *Gjurmime albanologjike*- folklor dhe etnologji: 331-348.

⁴² Halimi-Statovci, Drita. 2015. “Kontributi i Revistës Gjafë për albanologji dhe studime humane”. *Gjurmime albanologjike* - folklor dhe etnologji: 1-8. Po ashtu, nga viti 2010, në Institutin Albanologjik të Prishtinës mbahet konferenca “Java e Albanologjisë” në kuadër të së cilës mbahet edhe dita e etnologjisë, prej së cilës del përmbledhja me shkrime/kumtesa nga konferenca.

⁴³ Kadriu, Lumnije. 2009. *Glokalizmi; perceptime etnokulturore*. Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës; Kadriu, Lumnije. 2017. *Pushimet, familja, vendlindja në praktikën e diasporës shqiptare të Kosovës*. Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës; Canolli, Arsim. 2016. *Premisa antropologjike*, Prishtinë: Cuneus; Canolli, Arsim. 2018. *Flija: Vrojtim etnografik*, Tiranë: Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit, Akademia e Studimeve Albanologjike; Canolli, Arsim. 2019. *Teoritë antropologjike: Një hyrje e shkurtër*. Prishtinë: Fakulteti Filozofik, Universiteti i Prishtinës.

të thuhet se në Kosovë tashmë ka një gjeneratë të re antropologësh, që i kanë në fokus të studimeve të tyre qasjet plurale dhe prirjet shqyrtuese. Ndryshimet me studimet e një brezi më parë janë të dukshme. Një pjesë e mirë e këtyre studiuesve kanë doktoruar në universitete me emër në perëndim. Të tjerë kanë realizuar studime në master e doktoraturë pranë Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit në Tiranë. Një grup tjetër vijojnë studimet doktorature në lëmenj të ndryshëm të etnologjisë dhe antropologjisë në universitete prestigjioze perëndimore. Të gjithë këto flukse janë një parakusht shumë i mirë për të menduar se antropologjia kosovare ka një mundësi shumë të mirë zhvillimi.

Asgjëmangut, në ditët e sotme, mund të vlejë një ftesë për studimin e tjetrit në Kosovë. Antropologjia vendase do të përfitonte shumë të përfshinte brenda vetvetes aftësinë dhe eksperiencën e të studiuarit të tjetrit. Kosova është një nga territoret më sfiduese për antropologun vendas, pasi do të ishte sfidë që të kishim studime, të themi, të shqiptarëve mbi pakicën serbe në Kosovë, për vetë raportet historike dhe aktuale që këto dy kombe kanë në mes tyre. Po aq i rëndësishëm do të ishte studimi i minoriteteve të tjera të formuara pas luftës, në kontekst të politikave ndërkombëtare të ndërtimit të shtetit të Kosovës, që është modeluar si shtet i komuniteteve. Në anën tjetër, edhe studimi i antropologut kosovar, i etnisë shqiptare në kontekste të ndryshme, në Maqedoni të Veriut, Serbi, Mal të Zi, por edhe i shoqërisë shqiptare në Shqipëri, do të ishte po aq sfidues; se si artikulohet vetja në raport me tjetrin në vendin tënd, dhe se si artikulohet tjetri në raport me veten në vendin e tjetrit – kjo do të përbënte një kthesë ontologjike. Por se çfarë imagjinate do të ketë antropologjia kosovare në të ardhmen, mbetet për t'u parë.

Përmbajtja e këtij vëllimi

Vëllimi *Kosova antropologjike* ka një grup më të ngushtë studimesh, se sa u paraqitën gjatë ditëve të simpoziumit me titull “Perspektiva studimore mbi Kosovën”, organizuar në sallën “Rrok Zojzi”, Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit, Tiranë. Në vijim po japim një përmbledhje të tyre.

Lumniye Kadriu vjen me një kontribut në lëmin e transnacionalizmit. Analiza e Kadriut konsiston në kërkime të realizuara në terren, në

përveçimin e transnacionalizmit si një fushë sociale. Risjellja e analizës së strukturës familjare në Kosovë është e mirëpritur, sikurse e vë theksin vetë Kadriu te një traditë lokale e të studiuarit të familjes. Konkretnisht është fjala për punën e kryer më parë nga etnologu Mark Krasniqi. Ndërsa tani, puna e paraqitur nga Kadriu vë në shqyrtim kuptimin dhe funksionin social dhe ekonomik të familjes, duke e parë në kushtet e një jete të vendosur në mes botëve të ndryshme, transnacionale. Pikëvështrimi kryesor vendoset te funksioni gjatë pushimeve. Duke hetuar pushimet në vendlindje, raportet familjare, investimet familjare, ndarjen e punës dhe të mirat, sillen të dhëna dhe analizohen trajektoret e ndryshimeve të konceptimit të familjeve të mëdha.

Arsim Canolli, duke na treguar hyrjen nga “dera e vogël” për në “oborrin” e studimit antropologjik të Kosovës, nëpërmjet reflektimit dhe analizës, paraqet njëherazi rrugëtimin e vet etnografik e antropologjik, serinë e pyetjeve etnografike të hetuara dhe atyre që ende janë pjesë e pyetjeve dhe vrojtimeve etnografike. Një udhë që përbashkon tri tema: bukën, muzeun etnografik dhe festivalin. Për secilën temë, veç e veç, parashtrohen të dhënat dhe qasja teorike, duke parë gradualisht territoret antropologjike ku ato pikëtakohen. Kësisoj, kalohet në analizë nga një shqyrtim i kulturës buknore, shqisat, ndjesitë, eksperiencia etnografike, te kureshtia e pyetjet mbi muzeun, deri te festivali e, më shumë akoma, te festiviteti në shtetin e Kosovës. Nëse për bukën konstatohet një botë në mes privates dhe publikes, madje nga personalja te kolektivja, muzeu shikohet nën syrin e shtetit si hisedar. Festalet folklorike janë në proces vrojtimi e analize nga Canolli, megjithatë ai vëren se janë mjedise antropologjike, ku mund të shqyrtohen një mori çështjesh që ndërlidhen vetiu me festivalin si objekt antropologjik, por edhe mund të shikohet si performancë politike, një vend fitimi të kapitalit social, mund të shihen si rite kalimi për shtetin e ri, si një vend të trashëgimimit të traditës, të vendit ku kultura shihet si relikto apo relikti në kulturë si themelore, e kështu me radhë. Në këtë trinom Canolli nuk pretendon të ndërtojë një antropologji të shtetit si pikëpamje e vrojtimin të ngrehinës politike, por problematizon pikat e takimit të kulturës, sjelljes e raporteve me shtetin, te buka, muzeu e festivali dhe ngre pyetje vazhdimisht për mundësitë e vrojtimin dhe shqyrtimit antropologjik.

Shemsi Krasniqi vjen me një punë mbi raportin në mes kulturës dhe natyrës dhe për këtë na fton të kemi një term të ri, ekokulturën, ndërsa linja e dytë ka të bëjë me kujtesën për luftën. Të dyja këto tema lidhen me faktin se janë dy skajet se si njeriu përballlet me vetë ekzistencën e tij, në njërën anë natyra e në anën tjetër lufta. Të dy temat nuk janë parë si pjesë e një projekti e as si ndërlidhje, por janë projekte të ndara kërkimore. Në pjesën e parë shikohet dhe analizohen kujtime, norma, tradita mite e besime mbi natyrën. Një temë kjo që, edhe pse nuk mëton të jetë në krye të herës një antropologji për mjedisin, e angazhuar apo aplikative, i flet lexuesit, në njërën anë, për trashëgiminë kulturore, mbi natyrën, në krahun tjetër, lëshohen sinjale për gjendjen se si është kjo kulturë në ditët e sotme dhe jepen të dhëna për mënyrën se si këto norma e tradita të dikurshme, që mund të jenë, së paku, si kujtesë aty-këtu, apo të plota në segmente të caktuara, mund të rivitalizohen dhe përdoren në të tashmen dhe në të ardhmen. Në pjesën e dytë kemi të bëjmë me kujtesën për/dhe mbi luftën. Paraqitet një projekt sociologjik, bazuar në pyetësor të strukturuar dhe puna në grup, ndryshe nga pjesa e parë që është një projekt individual dhe në themel është kërkimi etnografik. Të dy këto projekte, njëherazi dy përvoja, sjellin për lexuesin edhe normën, edhe përvojën, së pari, të njeriut ndërjetësuar me natyrën, së dyti, praktikën dhe kujtimet si një përballje me eksperiencën e luftës, idesë së shpërnguljes, shfarosjes.

Nebi Bardhoshi merr në analizë dhe reflekton mbi tezat e trajtuara më parë, si marrëdhëniet ndërnjerëzore mbi marrëdhënien e pronësisë në kushtin e kualitetit ligjor, kanunin përkundrejt së drejtës shtetërore, duke e parë njeriun si një subjekt historik të disa projekteve të ndryshme modernizuese, të cilat kishin në themel të tyre ndryshimin e kulturës në tërësi dhe asaj ligjore në veçanti. Paraqiten në mënyrë të përmbledhur projektet kërkimore, zonat ku është realizuar kërkimi etnografik dhe botimet kryesore. Ftesa teorike shkon duke u përthelluar drejt kushtit të të jetuarit në zona të ndërmjetme apo kalimtare dhe, prej këtu, parashtrohen vështrime mbi ndryshimet në kulturën ligjore dhe në imazhin e shtetit e shtetërores. Ndër të tjera, parashtrohet mundësia për të analizuar sferat e shkëmbimit, artikuluar nga njerëzit apo nga kozmoset dhe rendet ligjore që përballen në mes tyre, duke shënuar edhe strategjitë e shmangies, përballjes. Në fund paraqitet një përmbledhje e shkurtër e projektit kërkimor, që autori

është duke e vijuar, mbi temën e kulturës ligjore dhe politike, me shqetësimin për të parë nëse jemi para një situatë, ku po krijohen e shetohen kushtet për një shoqëri e kulturë më demokratike, apo po inkurajohen regjime autoritare.

Durim Abdullahu vjen me një parashtrim e reflektim mbi narracionet dhe potencialin për narracionet për luftën. Periudha kohore që rrok kjo temë është ajo e pas vitit 1999. Një vëzhgim i tillë e shpie autorin të analizojë diskursat publike dominante mbi luftën dhe, prej këtui, te potenciali për pasjen e disa narracioneve të tjera. Temë kjo delikate, pasi flet për pasojat e kujtesën e luftës, që shkaktojnë te njerëzit premisat për trajta specifike të rrëfimit të eksperiencës së ndodhur para proceseve që shkaktuan zhdukjen, dhunimin psikik, dhunimin seksual e me radhë. Abdullahu ndalet edhe mbi mënyrën se si narracionet për luftën funksionalizohen në *kohë pas lufte* nga elitat. Një vend të posaçëm i kushtohet gjuhëve të rrëfimit krijuar nga organizata të ndryshme jo qeveritare dhe ngërçet që mbartin terma e terminologji të ndryshme, si mekanizma të shprehjes së gjendjeve të krijuara. Në tekst analizohen propozime të ndryshme narrativash, të cilat sfidojnë ato dominante, ose komunikojnë me to, kritikohet roli i shtetit për mospasjen e një platforme të qartë mbi të cilën të ndërtohet një gjuhë më e përplotë dhe me mundësi më të mëdha shprehëse dhe përfaqësuese.

Zanita Halimi vjen me një kontribut mbi fotografinë familjare. Pas një parashtrimit të teorive dhe mënyrave se si është studiuar fotografia, Halimi na vë në pah se fotoja nuk është thjesht një dëshmi materiale që shpreh vizualitetin e një çasti të stampuar, por ajo është në vetvete një shprehje e lidhjeve sociale dhe emocionale në mes njerëzve. Si e tillë, fotografia e meriton një vëmendje antropologjike në mënyrë specifike qoftë për aspektin afektiv, qoftë për atë social në kuptimin strukturor. Analiza përqendrohet te kuptimi, historia, domethënia e fotos në tri periudha të ndryshme kohore, përkatësisht vitet 1950-1981, 1981-1999, 1999 dhe në vijim. Kohësia e ndjekur për të grupuar fotot është ajo politike, thënë ndryshe e kohësisë politike të Kosovës dhe në brendi është parë se si reflektohet kjo kohësi, duke i dhënë përparësi vetë historisë së fotos. Metoda e ndjekur për studim është ajo etnografike, e një pune në terren mbi foton, ndryshe një etnografi për foton në Kosovë, që implikon vetiu një etnograf të ulur diku në një cep,

e ku folësi fillon e rrëfen kujtimet, teksa mban fotot dhe lëshon tek etnografi kujtimet, mbresat, emocionet e fotos që ka në dorë.

Olsi Lelaj vjen me një kontribut, i cili ka në fokus të tij ekspeditën etnografike realizuar në kampet e refugjatëve kosovarë në Shqipëri gjatë periudhës dhe pak ditë pas përfundimit të Luftës së vitit 1999. Shkrimi shqyrton njëherazi problematikat dhe sfidat teorike me të cilat përballet etnografi dhe folkloristi post-komunist në Shqipëri, në përballje me sfidën për të studiuar pasojat e gjenocidit ushtruar në Kosovë (1998-1999). Analizohen rrethanat institucionale, lindja dhe zhvillimi i idesë së kërkimit etnografik, teknikat dhe temat e përzgjedhura nga ekipi i punës për realizmin e kësaj ekspedite, duke e vendosur në kontekst me planet dhe zhvillimet e tjera brenda dhe jashtë institucionale. Shquhen me kujdes teknikat dhe metodat për mbledhjen dhe dokumentimin prozaik dhe vizual, bazuar në platformën kërkimore si dhe në bazë të analizës së materialit vizual të mbledhur në këtë ekspeditë. Veç shënimeve të publikuara në revistën *Kultura popullore*, dokumentit të mbajtjes së konferencës shkencore, ku janë prezantuar rezultatet e kësaj ekspedite, një peshë specifike i kushtohet dokumentimit vizual, përkatësisht fotove dhe videove, duke pasur në fokus kapjen e politikave kërkimore. Në fund kemi një përmbyllje ku paraqiten reflektime e krahasime në mes etnologjisë socialiste dhe asaj albanologjike, duke pasur në qendër të vëmendjes ekspeditën në fjalë.

Bibliografi

- Abdullahu, Durim. 2018. *Udhëpërshkrime shqiptare*. Prishtinë: Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”.
- Ami Boué. 1854. *Recueil d'itinéraires dans la Turquie d'Europe. détails géographiques, topographiques et statistiques sur cet empire*. Vienna: W. Braumüller.
- Ante, Arta. 2010. *Statebuilding and Development: Two sides of the same coin? Exploring the case of Kosovo*. Hamburg: Disserta Verlag.
- Backer, Berit. 2003. *Behind stone walls: Changing Household Organisation among Albanians of Kosovo*. Pejë: Dukagjini.
- Bardhoshi, Nebi. 2011. *Gurt e Kufinit: Kanuni, prona, strukturimi social*. Tiranë: Universiteti Europian i Tiranës.

- Bardhoshi, Nebi. 2013. "Legal Dynamics in Border Area Between Customary Law and State Law", *Journal of Legal Anthropology*, Vol. 1, nr. 3: 314-332.
- Bardhoshi, Nebi. 2016. "Small Number, Big Issues: The Border Areas as Social Arena of Legal Systems" Në *Exchange, Dialogue, New Divisions?*, përgatitur nga Sonja Schüler: 75-92. Wien: Lit Verlag.
- Bardhoshi, Nebi dhe Olsi Lelaj. 2018. *Etnografi në diktaturë: dija, shteti, holokausti ynë*. Tiranë: Akademia e Shkencave.
- Berger, Magarit. 2010. "Large Scale Anthropological Surveys in Austria-Hungaria, 1871-1918". Në *Doing Anthropology in Wartime and Warzones*, përgatitur nga Reinhard Johler, Christian Marchetti dhe Monique Scheer: 233-253. Beilefeld: Transcript Verlag.
- Beha, Adem. 2019. "Consociational Democracy and Political Engineering in Postwar Kosovo", *Nationalities Papers* 47:4: 674-689.
- Berisha, Rozafa. 2017. "Forgetting Equals Killing: Loss and Remembrance of the Missing Children in Post-War Kosovo". *Anthropology of East Europe Review*, nr. 35 (1): 35-54.
- Canolli, Arsim. 2006. "Filmi etnografik: Një pamje e shfaqjes dhe e zhvillimit të tij", *Gjurmime albanologjike: folklor-etnologji*, Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, 331-348.
- Canolli, Arsim. 2014. *Behind Open Doors: Restaurants and Food Culture in Kosovo*. Tezë doktore, University College London. <https://discovery.ucl.ac.uk/id/eprint/1452980/>, konsultuar për herë të fundit më 20 dhjetor 2020.
- Canolli, Arsim. 2016. *Premisa antropologjike*. Prishtinë: Cuneus.
- Canolli, Arsim. 2017. "Me ra s'kie ku shkon, me nejtë s'ke ku rrin: një pamje etnografike e migrimit fshat-qytet në Kosovë". *Studime shoqërore*: 49-70.
- Canolli, Arsim. 2018. *Flija: Vrojtim etnografik*. Tiranë: Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit, Akademia e Studimeve Albanologjike.
- Canolli, Arsim. 2019. "Kujtesa e mbijetesës së provueme". Në *Kujtesa e Kosovës: rrëfime të 100 pleqeve e plakave të Kosovës (10 vëllime)*: 19-26, Prishtinë: Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani".

- Canolli, Arsim. 2019. *Teoritë antropologjike: Një hyrje e shkurtër*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Filozofik.
- Çoçaj, Nexhat. 2011. *Hasi, Enciklopedi Etnokulturore: Gjeografia, trashëgimia familjare, familja, jeta sociale*, Prizren: Milleniumi i Ri.
- Çoçaj, Nexhat. 2011. *Hasi: Ritet e lindes dhe vdekjes*, Prizren: Milleniumi i Ri, Vëllimi II.
- Çoçaj, Nexhat. 2011. *Hasi Enciklopedi Etnokulturore: Veshje tradicionale të Hasit*, Prizren: Milleniumi i Ri.
- Çoçaj, Nexhat. 2011. *Hasi Enciklopedi Etnokulturore: Mallkime dhe urime*. Prizren, Melleniumi i Ri, Vëll. IV.
- Çoçaj, Nexhat. 2014. *Zonat e ndërmjetme etnografike në Kosovë*. Tezë doktore. Tiranë: Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit.
- Di Lellio, Anna dhe Stephanie Schwander-Sievers. 2006. "The legendary commander: The construction of an Albanian master-narrative in post-war Kosovo". *Nations and Nationalism*, 12 (3): 513-529.
- Durham, Edith. *Shqipëria e epërme: një udbëtim në Shqipërinë e Veriut të vitit 1908*. Tiranë: IDK.
- Durham M. Edith. 1909. *High Albania*. London: Edward Arnold Publishers to India Office.
- Evans, Arthur. 1883. "*Antiquarian researches in Illyricum. (Parts I and II)*", *From The Archaeologia Vol. XLVIII*. Westminster: Nichols and Sons.
- Evans, Arthur. 1885. *Antiquarian researches in Illyricum, Parts III, IV*", *Archaeologia: Miscellaneous Tracts Relating to Antiquity*. Volume XLIX. London: Nichols and Sons, for the Society of Antiquaries of London.
- Evans, J. Arthur. 2006. *Ancient Illyria: An Archaeological exploration*, London: London: IB Tauris & Centre for Albanian Studies.
- Evans, J. Arthur. 2017. *Albanian Letters: Nationalism, Independence and the Albanian League*, përgatitur nga Bejtullah Destani dhe Jason Tomes. London: IB Tauris & Centre for Albanian Studies.
- Goranoviè, Giovano. 2008. "On a Not So Well Tempered Marxism: Ideological Criticism, Historical Reconstructions, and a Late Return to Ethnogenesis in the Work of Špiro Kulišić". Në *Studying Peoples in the People's Democracies II: Socialist Era Anthropology in southeast Europe*,

- Vëll 17, përgatitur nga Vintilă Mihălescu, Ilia Iliev, Slobodan Naumović: 307-336. Berlin: Lit Verlag
- Gjorgjeviç, Vladan, 2015 [1913], *Shqiptarët dhe fuqitë e mëdha*, Tiranë: Klubi i Poezisë.
- Hahn, v. Georg. 2007. *Studime shqiptare*, Tiranë.
- Hahn, v. Georg. 2006. *Udhëtim nëpër viset e Drinit dhe Vardarit*, Prishtinë: Rozafa.
- Hahn, v. Georg. 2015. *The Discovery of Albania: Travel Writing and Anthropology in the Nineteenth Century Balkans*, përkthyer nga Robert Elsie. London: IB Tauris & Centre for Albanian Studies.
- Halimi-Statovci, Drita. 1982. *Zhvillimi i zejtarisë dhe rëndësia e saj bashkëkohore për strukturën ekonomike – shoqërore të KSA të Kosovës*, Prishtinë: IAP.
- Halimi-Statovci, Drita. 1981. “Shënime nga mjekësia popullore në tri treva të Kosovës”, *Gjurmime albanologjike*, seria folklor etnologji, nr. 10: 59-68.
- Halimi-Statovci, Drita. 1994. “Mbi përkujtimet”, *Gjurmime albanologjike*, seria folklor etnologji, nr. 24: 53-74.
- Halimi-Statovci, Drita. 1996. “Disa veshje shqiptare në Mal të Zi”. *Gjurmime albanologjike*, seria folklor etnologji, nr. 25: 61-82.
- Halimi-Statovci, Drita. 2004. “Mendësi dhe besime popullore për shtëpinë”. *Gjurmime albanologjike*, seria folklor etnologji, nr. 31: 91-110.
- Halimi-Statovci, Drita. 1988. *Kërkime etnografike*, Prishtinë: Rilindja.
- Halimi-Statovci, Drita. 1998. *Etnologjia flet*. Prishtinë: IAP.
- Halimi-Statovci, Drita. 2009. *Veshjet shqiptare të Kosovës*. Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës.
- Halimi-Statovci, Drita. 2013. *Nga djepi në përjetësi*. Prishtinë: IAP.
- Halimi-Statovci, Drita. 2015. “Kontributi i Revistës GJAFE për albanologji dhe studime humane”, *Gjurmime albanologjike* - folklor dhe etnologji, Vëll. 45: 1-8.
- Halimi-Statovci, Drita. 2018. *Pikturimi i fytyrës në Kosovë ndërmjet traditës dhe modernitetit*, Prishtinë: Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
- Halimi, Zanita. 2013. “Hindu-kultura në mjedisin kosovar shoqëror”, *Njohja*, nr. 2: 77-84.
- Halimi, Kadri. 2011. *Studime etnologjike*. Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, 5 vëllime.

- Halimi-Statovci, Drita. 2011. *Një jetë ndërmjet shkencës dhe atdhetarisë*. Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës.
- Halpern, Joel. 1956. *A Social and Cultural Change in a Serbian Village*, New Haven: Human Relations Area Files
- Halpern, Joel. 1969. "Observations on Intellectual History of Ethnology and Other Social Sciences in Yugoslavia". *Comparative Studies in Society and History*: 17-26
- Hann, Chris. 2002. 'Introduction'. Në *Postsocialism: Ideals, ideologies, practices in Eurasia* përgatitur nga Chris Hann. London: Routledge: 1-28.
- Heming, Andreas. 2012. "German speaking Travel Writers in interwar Albania". Në *Albania: Family, Society and Culture in 20th Century* përgatitur nga Andreas Hemming, Gentiana Kera dhe Enriketa Pandelejmoni: 115-130. Graz: Lit Verlag.
- Howard, Clark. 2000. *Civil Resistance in Kosova*. London: Pluto Press.
- Iveta Rajkovič, Mirjeta dhe Rina Geci. 2017. "Kosovar Albanian Goldsmiths and Bakers in Zagreb: Migration and Ethnic Entrepreneurship". *Studia ethnologica Croatia*, vol. 29: 305–330.
- Kadriu, Lumnije. 2009. *Glokalizmi; perceptime etnokulturore*. Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës.
- Kadriu, Lumnije. 2017. *Pushimet, familja, vendlindja në praktikën e diasporës shqiptare të Kosovës*. Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës.
- Kadriu, Lumnije. 2018. "The Transnational Family Between Preserving the Old and Acquiring the New way of Life". *Etnologia Balcanica*, Vol. 21:173-193.
- Kostovicova, Denisa. 2005. *Kosovo: The Politics of Identity and Space*, Routledge: London.
- Krasniqi, Elife. 2011. "Illegalja: Women in the Albanian Underground Resistant Movement in Kosovo", *ProFemina*, Special edition no 2: 99-111.
- Krasniqi, Elife. 2014. "Women in Search for Social Security: Hostage of Family, Tradition and State". Në *All Equal Real: Femenities and Masculinities*, përgatitur nga Anna Plíńska dhe Harmony Singaporita: 203-214. Oxford: Inter-Disciplinary Press

- Krasniqi, Elife. 2015. "Social Change in Relation to Patriarchy after 1999 War in Opoja, Kosovo". Në *Culture of Crisis in Southeast Europe, Part I, Ethnologia Balcanica*, Vol. 18: 191-206.
- Krasniqi, Gëzim. 2011a. "Socialism, National Utopia, and Rock Music: Inside the Albanian Rock Scene of Yugoslavia, 1970–1989", *East Central Europe* Vol. 38. Nr. 2-3: 336–354.
- Krasniqi, Gëzim. 2011b. "The 'forbidden fruit': Islam and politics of identity in Kosovo and Macedonia", *Southeast European and Black Sea Studies* Vol. 11, Nr. 2: 191-207.
- Krasniqi, Gëzim. 2012. "Overlapping jurisdictions, disputed territory, unsettled state: the perplexing case of citizenship in Kosovo". *Citizenship Studies* Special Issue: Citizenship in the New States of South Eastern Europe, Vol. 16, No. 3-4: 353 – 366.
- Krasniqi, Mark. 1977. "Krahinat etnografike të Kosovës", *Konferenca kombëtare e studimeve etnografike*, Tiranë: Akademia e Shkencave të Republikës Socialiste të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Sektori i Etnografisë: 111-120.
- Krasniqi, Mark. 1979. *Gjurmë e gjurmime*, Prishtinë: Instituti Albanologjik.
- Krasniqi, Mark. 1984. *Lugu i Baranit*, monografi etno-gjeografike, Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve.
- Krasniqi, Mark, përg. 1987. *Rugova: monografi etnografike*, Prishtinë: ASHAK.
- Krasniqi, Mark. 1991. *Nga gurra e traditës*, Prishtinë: Zëri.
- Krasniqi, Mark, 1995. "Ndikimi i shkencës në formimin e një etnopsikologjie të gabuar". *Gjurmime albanologjike: folklor dhe etnologji*, 24: 7-19.
- Krasniqi, Mark. 1997. *Aspekte mitologjike: besime e bestyttni*, Prishtinë: Rilindja.
- Krasniqi, Mark. 2012. *Kujtime e përjetime: shënime biografike 1920-2012*. Pejë: Dukagjini.
- Krasniqi, Sadik. 2020. "History of Museum Heritage in Kosovo". Në *Book of Proceedings, Educational and Social Sciences Conference* 10 shkurt 2020: 117-130. Barcelona: International Academic Institute.
- Krasniqi, Shemsi dhe Albert Simkus. 2015. "Differences in Values Among Groups Within Kosovo" në *Civic and uncivic values in Kosovo: History, politics, and value transformation* përgatitur nga Sabrina P. Ramet, Albert

- Simkus dhe Ola Listhaug: 295-321. Budapest & New York: Ceu Press,.
- Krasniqi, Shemsi. 2017. *Ekokultura: natyra në kulturën popullore shqiptare*. Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës.
- Krasniqi, Vjollca. 2014. "The Topography of the Construction of the Nation in Kosovo". Në *Strategies of Symbolic Nation-Building in South Eastern Europe* përgatitur nga Pål Kolstø: 104-106. London: Ashgate.
- Jezernik, Božidar. 2003. *Wild Europe: The Balkans Through the Gaze of Western Travellers*. London: Saqi Books.
- Lajçi, Bashkim. 1994. "Funksioni i veshjes në besimet popullore shqiptare", *Gjurmime albanologjike*, seria folklor-etnologji, 23: 187-192.
- Lajçi, Bashkim. 2001. "Tabuizimi i emrave në Rugovë", *Gjurmime albanologjike*, seria folklor-etnologji, 28-29/1998-1999: 141-147.
- Lajçi, Bashkim. 2002. "Martesa në traditën tonë popullore", *Gjurmime albanologjike*, seria folklor-etnologji, nr. 32: 133-142.
- Lajçi, Bashkim. 2007. "Motivet astrale në ornamentikën tonë popullore", *Gjurmime albanologjike*, seria folklor-etnologji, nr. 36: 233-240.
- Lajçi, Bashkim. 2007. *Gjurmime etnologjike*. Pejë: Bashkim Lajçi.
- Lajçi, Bashkim. 2008. "Mbi disa mënyra të mbrojtjes nga syri i keq". *Gjurmime albanologjike*, seria folklor-etnologji, nr. 37: 255-275.
- Lajçi, Bashkim. 2011. "Funksioni i armës në doket e zakonet tona popullore", *Gjurmime albanologjike*, seria folklor-etnologji, nr. 40-2010: 141-148.
- Lajçi, Bashkim. 2013. *Syri i keq në besimet shqiptare*. Prishtinë: IAP.
- Lajçi, Bashkim. 2014. *Tabu në etnokulturën shqiptare*. Prishtinë: IAP.
- Latifi, Tahir. 2019. "Generational and intergenerational care and mobility networks in Kosovo". *Südosteuropa. Journal of Politics and Society*, vol. 67 (2): 196-210.
- Latifi, Tahir. 2018. "The Culture of Relatedness in Kosovo: The Role of Kinship in the Private and the Public Sphere". *Studia Ethnologica Croatica*, Vol. 30. nr.1: 147-168.
- Landau, Dana. 2017. "The quest for legitimacy in independent Kosovo: the unfulfilled promise of diversity and minority rights". *Nationalities Papers*, 45:3: 442-463.

- Latifi, Tahir. 2014. "Gender and Family Relations, Women in Search for Social Security". *All Equal Real? Femenities and Masculinities*, përgatitur nga Anna Plínska dhe Harmony Singaporja: 191-202. Londër: Inter-Disciplinary Press, Oxford.
- Leutloff-Grandits, Caroline. 2019. "When Men Migrate for Marriage: How Kosovo-Albanian Couples Cope with Gender Stereotypes and Immigration Barriers in Germany and Austria". *Journal of Ethnic and Migration Studies. Special Issue on Cross-Border Marriages: Intersecting Categories from the Perspective of States, Spouses and Researchers*, vol. 47/2: 397-412.
- Leutloff-Grandits, Caroline. 2019. "Kinship and Safety Nets in Croatia and Kosovo". Në *Everyday Life in Balkans*, përgatitur nga, David. W. Montegomero: 63-76. Bloomington: Indiana University Press,.
- Lockwood, William. 1975. *European Moslems: Economy and Ethnicity in Western Bosnia*. New York: Academic Press.
- Lovro Mihačević. 1913. *Durch Albanien: Reise-Eindrücke*. Prague: Bonifatius.
- Luci, Nita. 2014. *Seeking Independence: Making Nation, Memory, and Manhood in Kosova*, Tezë doktorature, Universiteti i Michigan-it.
https://deepblue.lib.umich.edu/bitstream/handle/2027.42/107225/n_luci_1.pdf?sequence=1&isAllowed=y, konsultuar për herë të fundit më 20 dhjetor 2020.
- Mihaçeviq, Lovro. 2006. *Nëpër Shqipëri: mbresa udhëtimi & etnografi (1883-1907)*. Lezhë: Gjergj Fishta.
- Motesi, Mary. 2017. *Kosova: Preludi i luftës 1966-1999*. Prishtinë: Alter Habitus.
- Malcolm, Noel. 1998. *Kosovo: A Short History*. Macmillan: Basingtoke
- Marschand, Suzzane. 1996. "Orientalism as Kulturpolitik: German Archeology and Cultural Imperialism in Minor Asia". Në *Volgeist as Method and Ethic: Essays on Boasian Ethnography and the German Anthropological Tradition, History of Anthropology*, Vol.i VIII përgatitur nga George Stocking: 298-336, London: The University of Wisconsin Press,.
- Marchetti, Christian. 2014. "Austro-Hungarian Volkskunde at War Scientists in Ethnographic Mission". Në *Doing Anthropology in Wartime*

- and Warzones*, përgatitur nga Reinhard Johler, Christian Marchetti dhe Monique Scheer: 207-230. Beilefeld: Transcript Verlag.
- Musliu, Vjosa. 2019. "Spectres of Kosovo: 20 Years of Liminality and Aporia", *Journal of Intervention and Statebuilding*, 13/5: 556-565.
- Pandolfi, Mariella. 2009. *Sovranitete të lëvizshme: Kujtesa, konflikti, dhuna në Ballkanin e erës globale*. Tiranë: IDK.
- Pasqyra shkencore 2019. Tiranë: Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit, Akademia e Shkencave Albanologjike,.
- Promitzer, Christian. 2015. "Austria and the Balkans: Explaining the Role of the Travelogues in the construction of an Area." Në *Southeast European Studies in a Globalising World*, përgatitur nga Christian Promitzer, Siegfried Gruber, Harald Heppner: 189-206. Wien: Lit Verlag.
- Promitzer, Christina. 2014. "Betwixt and Between": Physical Anthropology in Bulgaria and Serbia until the End of the First World War". Në *Doing Anthropology in Wartime and War Zones: World War I and the Cultural Sciences in Europe*, përgatitur nga Reinhard Johler, Christian Marchetti dhe Monique Scheer: 141-166. Bielefeld: Transcript Verlag. <https://doi.org/10.14361/9783839414224-008>
- Promitzer, Christian. 2011. "Degeneration, Darwinism, and Development of Eurgences in Bulgaria, 1880-1929". *East Central Europe*, 38: 44-63.
- Reineck, Janet. 1991. *The Past as Refuge: Gender, Migration and Ideology among Kosovo Albanians*. Tezë doktore. Universty of California. https://www.esiweb.org/pdf/kosovo_reineck_dissertation.pdf , konsultuar për herë të fundit më 12 dhjetor 2020
- Schwander-Sievers, Stephanie. 1999. *The Albanian Aromanians' Awakening: Identity Politics and Conflict in Post-communist Albania*. Flensburg, Germany: European Centre for Minority Issues (ECMI).
- Schwander-Sievers, Stephanie. 2005. "'Culture' in Court: Albanian Migrants and the Anthropologist as Expert Witness". Në *Applications of Anthropology: Professional Anthropology in the Twenty-first Century* përgatitur nga Sarah Pink: 209-228. Oxford - New York: Berghahn Books
- Schwander-Sievers, Stephanie dhe Anna Di Lellio. 2006. "Sacred Journey to a Nation: the Construction of a Shrine in Postwar Kosovo". *Journeys: The International Journal of Travel and Travel Writing*, 7 (1): 27-49

- Schwander-Sievers, Stephanie. 2009. "Securing Safe Spaces: Field Diplomacy in Albania and Kosovo". Në *Women Fielding Danger: Negotiating Ethnographic Identities in Field Research* përgatitur nga Martha K. Huggins dhe Marie Loise Glebbeek: 173-198. Boulder, New York and Oxford: Rowman & Littlefield Publishers
- Schwander-Sievers, Stephanie. 2010a. "Invisible - Inaudible: Albanian Memory of Socialism after the War in Kosovo". Në *Post-Communist Nostalgia* përgatitur nga Maria Todorova dhe Zsuzsa Gille: 96-112. New York: Berghahn Books
- Schwander-Sievers, Stephanie. 2010b. "Between Social Opprobrium and Repeat Trafficking: choices and chances of Albanian women deported from the UK". Në *Trafficking and Human Rights: European and Asia-Pacific Perspectives* përgatitur nga Leslie Holmes: 95-115 Cheltenham: Edward Elgar Publishing
- Schwander-Sievers, Stephanie dhe Isabel Ströhle. 2012. "An Ethnography of 'Political Will': Towards a Thick Description of Internal Scripts in Post-War Kosovo". *Südosteuropa*, 60 (4): 497-513
- Schwander-Sievers, Stephanie. 2013a. "Democratisation through Defiance? The Albanian Civil Organisation 'Self-Determination' and International Supervision in Kosovo". Në *Civil Society and Transitions in the Western Balkans* përgatitur nga Vesna Bojicic-Dzelilovic, James V. Ker-Lindsay dhe Denisa Kostovicova: 95-116. London: Palgrave Macmillan
- Schwander-Sievers, Stephanie. 2013b. "The Bequest of Ilegalja: Contested Memories and Moralities in Contemporary Kosovo". *Nationalities Papers*, 41 (6): 953-970
- Schwander-Sievers, Stephanie. 2019. "Longing for lost normalcy: Social memory, transitional justice, and the 'house museum to missing persons in Kosovo". *Nationalities Papers*, 47 (2): 232-247
- Schwander-Sievers, Stephanie, Linda Gusia, Nita Luci, Lura Pollozhani. 2019. "Fragments on Heroes, Artists and Interventions: Challenging Gender Ideology and Provoking Active Citizenship through the Arts in Kosovo". Në *Post-Participatory' Arts for the 'Post-Development' Era* përgatitur nga Paul Cooke dhe Inès Soria-Dolan: 105-123 London: Routledge.

- Statovci, Drita. 1982. "Shqyrtime rreth organizatave zejtare", *Gjurmime albanologjike*, seria folklor etnologji, nr. XI-1981: 61-75.
- Statovci, Drita. 1986. "Disa udhëpërshkrime angloamerikane mbi pozitën e gruas shqiptare". *Gjurmime albanologjike*, seria folklor etnologji nr. 16-1: 63-70.
- Statovci, Drita. 1984. "Skicë për studimin e ushqimit popullor", *Gjurmime albanologjike*, seria folklor etnologji, XIII-1983: 131-140.
- Strohle, Isabel. 2012. "Re-Inventing Kosovo: Newborn and the Young European", në *Retracing Images. Visual Culture After Yugoslavia*, përgatitur nga Daniel Suber dhe Slobodan Karamanic, 223-250. Leiden: Brill.
- Schmitt, J. Oliver. 2012. *Kosova: një histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike*. Prishtinë: Koha.
- Shkodra, Valon. 2020. *Muzeu Etnologjik i Prishtinës*, Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës.
- Trashëgimia dhe transformimi i kulturës popullore: materiale nga sesioni shkencor*. 1983. Material nga sesioni shkencor, Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës.
- Turner, Victor. 1969. *The Ritual Process: Structure and Anti-Structure*. Oxford: Routledge.
- Zaum, Dominic. 2007. *Sovereignty Paradox: The Norms and Politics of International State-Building*. Oxford: Oxford University Press.
- Vermeulen, F. Hann. 2015. *Before Boas: The Genesis of Ethnography and Ethnology in German Enlightenment*. Lincoln&London: University of Nebraska Press.
- Vickers, Miranda. 1998. *Between Serb and Albanian: History of Kosovo*. New York: Columbia University Press.
- Visoka, Gëzim. 2017. *Shaping Peace in Kosovo: The Politics of Peacebuilding and Statehood*. Basingstoke, UK: Palgrave Macmillan.
- Vokshi, Mehmet. 1931. *Fisi i Vokshit*. Tiranë: Pa shtëpi botuese.
- West, Rebecca. 1941. *Black Lamb and Grey Falcon: A Journey Through Yugoslavia*. London: Macmillan.
- Weller, Marc. 2009. *Contested Statehood: Kosovo's Struggle for Independence*. Oxford: Oxford University Press.

- Xhemaj, Ukë. 2003. *Etnokultura shqiptare në Podgur*. Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës.
- Xhemaj, Ukë. 1989. "Mbijetojat arkaike në strukturën dhe organizimin e familjes shqiptare në Kosovë", *Gjurmë e gjurmime*: seria folklor-etnologji.
- Xhemaj, Ukë. 1979. "Reliktet e besimeve pagane e totemike në Opojë e Gorë", *Gjurmë e gjurmime*: seria folklor-etnologji, nr. 9: 99-112.
- Xhemaj, Ukë. 1983. "Relikte të kultit të gjarprit në traditën popullore shqiptare", Prishtinë, *Gjurmime albanologjike*: seria folklor - etnologji, nr. 13: 23-33.
- Xhemaj, Ukë. 1984. "Për disa çështje rreth kuvadës ndër shqiptarë". *Gjurmime albanologjike*: seria folklor - etnologji, nr. 14: 129-141.
- Xhemaj, Ukë. 1985. "Riti i thirrjes së shiut dhe riti i ndaljes së breshrit", *Gjurmime albanologjike*: seria folklor - etnologji, nr. 15: 27-40.
- Xhemaj, Ukë. 1986. "Gjurmë animizmi në besimet rreth drunjve", *Gjurmime albanologjike*: seria folklor - etnologji, nr. 16: 99-105.
- Xhemaj, Ukë. 1988. "Rite motmoti dhe besime të tjera mitologjiko-agrare në Kosovë", *Gjurmime albanologjike*: seria folklor - etnologji, nr. 18: 7-26.
- Xhemaj, Ukë. 1989. "Mbijetojat arkaike në strukturën dhe organizimin e familjes shqiptare në Kosovë", *Gjurmime albanologjike*: seria folklor - etnologji, nr. 19: 153-169.
- Xhemaj, Ukë. 2005. *Shtresime kulturore*. Prishtinë: IAP.
- Živković, Marko. 2011. *Serbian Dreambook: National Imaginary in the Time of Milošević*. Bloomington: Indiana University Press